



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në;

“Financë- Bankë

Universiteti Privat “Albanian University”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Albana Gjoni
2. Prof. Asoc. Dr. Orkida Ilollari

Dhjetor/2024

Tabela përmbledhëse për programin e studimit Bachelor në :

“Financë-Bankë”

1	IAL aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Ekonomike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Financë-Bankë
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër nr.8981, Datë 27.12.2005
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresë MASR Nr. 2600/1 datë 02.06.2021 (Vendim Senati nr. 9, datë 07.04.2021)
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 388, datë 28.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër Nr. 79, Datë 05.10.2019
8	Cikli i studimit:	Bachelor
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 (tre) vite akademike/6(gjashtë) semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 Kredite
11	Forma e studimit:	Me Kohë të Plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	N/A
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	N/A
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2023-2024 14 PAE/8PAK 2022-2023 14 PAE/ 10 PAK 2021-2022 11 PAE/8 PAK
18	Numri i studentëve të regjistruar dhe transferuar në programin e studimit “Financë-Bankë”:	2019-2020 42 2021-2022 58 2022-2023 27 2023-2024 32
19	Komente / të tjera:	N/A




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)

Programi Bachelor në “Financë-Bankë” është licencuar me urdhër nr. 8981, datë 27.12.2005. Ky Program është akredituar për herë të parë me VKA nr.50, datë 27.10.2009 dhe me urdhër nr.541, datë 01.12.2010. Akreditimi i fundit për programin është dhënë nga Bordi i Akreditimit me Vendim nr.79 me datë 5.10.2019. Programi Bachelor në “Financë-Bankë” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Ekonomike. Departamenti i Shkencave Ekonomike është njësi bazë akademike që zhvillon procesin e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor në fusha të lidhura me profilet ekonomike të njohura dhe licencuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Departamenti i Shkencave Ekonomike është pjesë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Albanian University (AU) është një institucion privat, i pavarur dhe laik i Arsimit të Lartë, i cili është licencuar në Prill të vitit 2004 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. Programi i parë i hapur në AU në fushën e Ekonomisë është Programi Bachelor në “Financë-Bankë. Programi është strukturuar për të edukuar studentët me njohuritë bazë në fushat e menaxhimit të financave të një entiteti, administrimit të financave lokale, njohuri të cilat i ndihmojnë studentët të mendojnë në mënyrë analitike dhe kritike në lidhje me menaxhimin e fondeve dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme ekonomike. Qëllimi i programit është informimi dhe studimi i kombinuar i metodave bashkëkohore të analizës e menaxhimit financiar dhe bankar duke u pajisur edhe me njohuri rreth modeleve të analizave financiare për përdorimin e këtyre dijeve në të gjitha nivelet e menaxhimit financiar si dhe në të gjitha fushat e ekonomisë dhe biznesit. Objektivi kryesor i programit është transmetimi i njohurive gjithëpërfshirëse mbi mënyrat e menaxhimit të kapitalit financiar për bizneset, administrimin, organizimin, vendimmarrjen dhe marketingun modern të produkteve bankare duke bërë të mundur formalizmin e ekonomisë dhe edukimin financiar të brezit të ri të drejtuesve të biznesit.

Ky raport vlerësimi shqyrton veprimtarinë për pesë vite akademike të këtij program studimi dhe departamentit që e ofron, përkatësisht vitet 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023 dhe 2023-2024 të programit të studimit Bachelor në “Financë-Bankë”, duke u fokusuar në programin e studimit, misionin, kurrikulën, personelin akademik, politikat e formimit të studentëve, kërkimin shkencor, etj.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;


Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), i cili përbëhej nga **Prof. Asoc. Dr. Orkida Ilollari** dhe **Prof. Asoc. Dr. Albana Gjoni**, me miratimin e Bordit të Akreditimit dhe Agjensisë së Sigurimit dhe Cilësisë të Arsimit të Lartë (ASCAL), realizoi një vlerësim gjithëpërfshirës të programit Bachelor në “Financë-Bankë” të Albanian University (AU). Procesi u mbështet nga koordinatori teknike e ASCAL, znj. Anilda Beqiraj, dhe përfshiu analizimin e dokumentacionit të dorëzuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë (ASCAL) dhe të dhënave të tjera të siguruar nga AU.

Pikat kryesore të këtij procesi ishin Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) si dhe të gjitha evidencat dhe dokumentat, të përgatitura në bashkëpunim të stafit akademik dhe atij administrativ të universitetit. Të gjitha këto së bashku duke përfshirë edhe vizitën e GVJ-së ofruan një pasqyrë të qartë mbi gjendjen aktuale të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike (FSHAE) dhe Departamentit të Shkencave Ekonomike (DSHE). Gjithashtu RVB shërbeu si një burim kryesor për vlerësimin e jashtëm, duke theksuar përparësitë dhe sfidat e procesit arsimor dhe zhvillimor të institucionit.

Më datat, 30/10/2024 dhe 31/10/2024, GVJ zhvilloi një seri takimesh në AU me drejtuesit e njësive kryesore dhe personelin akademik e administrativ të përfshirë në programin e akredituar, duke përfshirë edhe intervista me Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) si dhe me studentët e programit “Financë-Bankë”. Gjithashtu, u realizua një inspektim i ambienteve të universitetit për të siguruar përputhjen me standardet e kërkuara.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) analizoi gjashtë standarde kyçe të akreditimit, ku secili standard u vlerësua në bazë të kriterëve të përcaktuara, të dhënave të RVB-së dhe evidencave shtesë. GVJ dha një vlerësim të qartë për secilin standard dhe përfshiu një analizë të detajuar të përmbushjes së tyre. Në përfundim, raporti nxjerr në pah pikat e forta dhe ato të dobëta të programit të ciklit të parë në Bachelor në “Financë-Bankë”, duke ofruar një përmbledhje të gjendjes së përgjithshme të tij dhe rekomandime për përmirësim.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 79 datë 05/10/2019 janë:

1. Institucioni, të rrisë përfshirjen e stafit akademik të këtij programi studimi në projekte kërkimore shkencore.
2. Institucioni, të vërë në dispozicion të studentëve të këtij programi studimi laboratorët e informatikës për realizimin e punëve të pavarura dhe detyrimeve jashtë orës së mësimi.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Në lidhje me rekomandimin e parë Institucioni ka bërë përpjekje serioze për të adresuar këtë rekomandim, duke çelur në vitin e fundit një fond të posaçëm për të mbështetur stafin akademik të institucionit. Megjithatë ende nuk figuron një rast konkret i stafit të departamentit që mbulon këtë program studimi që një artikull i botuar është financuar nga ky fond. Ka pak pjesëmarrje të stafit të departamentit në projekte shkencore, konferenca shkencore dhe botime artikujsh shkencorë me faktor impakti. Institucionit I mbetet përgjegjësia për të adresuar akoma më mirë këtë rekomandim për të rritur kualifikimin dhe promovimin e stafit për kërkim shkencor.

Rekomandimi i parë përmbushet kryesisht

Në lidhje me rekomandimin e dytë të lënë nga grupi i mëparshëm i akreditimit, në lidhje me ngritjen e laboratorit të informatikës, Institucioni e ka adresuar këtë rekomandim përmes ngritjes së një laboratorit informatike ku zhvillojnë mësim Studentët në lëndët e Informatikës, Statistikës dhe Kontabilitetit. Laboratori është i pajisur me një numër të kënaqshëm kompjuterash, përkatësisht 24 kompjutera të cilët janë të pajisur me programe finance e kontabiliteti dhe ofrojnë mundësitë e ilustrimit praktik të njohurive për studentët.


Rekomandimi i dytë përmbushet plotësisht



LISTA E SHKURTIMEVE

ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
AU	Albanian University
DSHE	Departamenti i Shkencave Ekonomike
FSHAE	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
GVB	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
GVJ	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
PAE	Personeli Akademik Efektiv
PAK	Personeli Akademik me Kontratë
RVB	Raport i Vlerësimit të Brendshëm
RVJ	Raport i Vlerësimit të Jashtëm
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZBNJ	Zyra e Burimeve Njerëzore
ZKA	Zyra e Karrierës dhe Alumnit
ZKMS	Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve

Universiteti Privat AU është njohur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 12.12.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr Prot 317/21, datë 12.12.2024. Institucioni njofton në ASCAL më datë 19.12.2024, nëpërmjet shkresës me Nr Prot 469/2, datë 19.12.2024. *Kthim përgjigje mbi DRVJ e programit të studimit Bachelor në "Financë-Bankë".*



GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Lidhur me komentet e institucionit për Standardin II.2, GVJ arsyeton se, pavarësisht përpjekjeve për të përmirësuar raportin PAE/PAK nga ana e Institucionit gjatë viteve akademike të marra në shqyrtim, ende ky raport vazhdon të qëndrojë larg kriterit ligjor 70%/30%. Si rrjedhojë, vlerësimet tona qëndrojnë, dhe:
Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.
2. Lidhur me komentet e institucionit për Standardin II.4, *Kriteri 5*, GVJ arsyeton se, pjesërisht syllabuset e disa lëndëve mësimore kanë nevojë për përditësim të literaturës bazë dhe të rekomanduar për studentët duke iu referuar kështu botimeve të teksteve të viteve të fundit si dhe teksteve të huaja të mirënjohura tashmë të ofruara në shqip dhe që kanë përfshirë në përmbajtje standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditimit. GVJ nga verifikimi i syllabuseve të dorëzuara nga vetë institucioni konstatoi botime dhe tekste të më shumë se 10-15 viteve më parë, dhe materialet mësimore në lidhje me këto lëndë kanë evoluar shumë për shkak të implementimit të standardeve ndërkombëtare. Si rrjedhojë, vlerësimet tona qëndrojnë, dhe:
Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.
3. Lidhur me komentet e institucionit për Standardin IV.1, GVJ arsyeton se, pavarësisht plotësimeve me staf PAE që AU shprehet se do të vijojë në vitet akademike të ardhshme, vlerësimi ynë referohet deri në fillimin e këtij procesi akreditimi, duke evidentuar situatën aktuale. Si rrjedhojë, vlerësimet tona qëndrojnë, dhe:
Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.
4. Lidhur me komentet e institucionit për Standardin IV.3, *Kriteri 1, Kriteri 3 dhe Kriteri 4*, GVJ arsyeton se, pavarësisht propozimeve nga departamenti si njësi bazë e këtij programi për shtimin e fondit fizik të bibliotekës me literaturë bashkëkohore, vlerësimi ynë i referohet periudhës deri në fillimin e këtij procesi, duke evidentuar situatën aktuale. Si rrjedhojë, vlerësimet tona qëndrojnë, dhe:
Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.
5. Lidhur me komentet e institucionit për Standardin IV.5, *Kriteri 2*, GVJ merr parasysh përgjigjen e argumentuar nga institucioni dhe në raport ky kriter është vlerësuar nga GVJ si 'Përmbushet Plotësisht'. Prandaj, raporti ***nuk ndryshon***, pasi ka marrë vlerësimin "*Plotësisht*". Si rrjedhojë, vlerësimet tona qëndrojnë, dhe:
Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.
6. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin V.1, *Kriteri 6 dhe 8*, GVJ arsyeton pasi eidentoi evidencën nr. 1 u vu re se institucioni ka miratuar kuotat për



këtë kategori. Pra, sa i përket Standardit V.I, vlerësimi nga GVJ *do të ndryshojë* dhe do të jetë: **"Përmbushet plotësisht."**


7. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin VI.1, *Kriteri 1*, GVJ përshkruan pozitivisht këtë kriter pasi evidentoi evidencën nr. 3.4 të *Manualit të Përdorimit të Platformës TEAMS*. Sa i përket të gjitha kriterëve të tjera të Standardit VI.1, vlerësimet tona qëndrojnë dhe:
Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.
8. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin VI.2, *Kriteri 1*, GVJ vlerësoi evidencën nr 6.4 *Strategjia për Sigurimin e Cilësisë 2022 – 2025* dhe **hoqi** komentet e mungesës së strategjisë për sigurimin dhe cilësinë.
9. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin VI.2, *Kriteri. 4*. GVJ arsyeton se megjithëse angazhimin serioz të institucionit për përmirësimin e cilësisë nëpërmjet strukturave të posaçme të ngritura nuk u evidentua një raport analize të rezultateve mbi dobësitë, të metat apo edhe pikat e forta në këtë program studimi. Si rrjedhojë vlerësimet tona qëndrojnë dhe:
Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.
10. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin VI.3, *Kriteri. 4*. GVJ ndryshoi komentin i cili konsistonte në mungesën e raportit të gjurmimit të studentëve, ndaj bazuar në *Evidenca: 5.14 Statistika të punësimit të studentëve* ky koment **ndryshoi**. Ndërkohë përsa i përket të gjithë standartit VI.3 vlerësimet tona qëndrojnë dhe:
Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë-Bankë”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësish kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi Bachelor në Financë-Bankë, i ofruar nga Departamentit të Shkencave Ekonomike nuk bie ndesh me interesat kombëtare, ky program synon të ndihmojë në ruajtjen e vlerave kombëtare dhe avancimin e shoqërisë dhe ekonomisë. Programi Bachelor në “Financë-Bankë” formon specialist në fushën e finances dhe bankës, të cilët transformohen në profesionistë që kontribuojnë në avancimin e ekonomisë, në zbatimin e administrimit eficient të fondeve publike duke qenë në harmoni me interesat kombëtare të Republikës së Shqipërisë. <i>Evidenca : 1.3.a Statuti AU</i> <i>Evidenca 1.1.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.</i> <i>Evidenca 1.4.a Rregullore e përgjithshme AU.</i> <i>Evidenca: 1.2 Rregullore e programit BSc.Financë-Bankë.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi Bachelor në “Financë-Bankë” është hartuar bazuar në strategjinë e Albanian University dhe ka për qëllim përmbushjen e misionit dhe qëllimeve të Universitetit në kuadër të përmbushjes së misionit kryesor të shpërndarjes së dijes. Ky program është në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimet e një arsimit bashkëkohor që kërkon t’i përgjigjet nevojave të tregut të punës, zhvillimit ekonomik të vendit dhe ruajtjes së vlerave kulturore të kombit. Programi është në përputhje me objektivin strategjik të Planit Strategjik të Zhvillimit Institucional në periudhën 2017-2022 dhe Strategjinë për zhvillimin institucional të AU në periudhën 2023-2028, si dhe ofrimin e programeve mësimore të përditësuara të transferueshme në tregje të punës kombëtare e rajonale. <i>Evidenca 1.1.a/Strategjia e Zhvillimit Institucional</i> <i>Evidenca 1.1.b/Plani Strategjik Institucional 2023-2028</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së	Programi i studimit Bachelor në Financë-Bankë i ofruar nga Departamenti i Shkencave Ekonomike i AU është në përputhje të plotë me vlerat akademike dhe kulturore të Republikës së Shqipërisë dhe të kombit shqiptar, në përputhje me politikat kombëtare të përcaktuara në “Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë” të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Programi i studimit Bachelor në Financë-Bankë është hartuar



Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit AU si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. <i>Evidenca 1.2/Rregullore e Programit BsC Financë Bankë</i> <i>Evidenca 1.3/Statuti i AU</i>			
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Institucioni Albanian University ka përvojë të gjatë në ushtrimin e aktivitetit të ofrimit të programeve të studimit, dhe pikërisht Programi i Studimit Bachelor në Financë Bankë ofrohet prej vitit 2005, është program i pare i ofruar nga ky institucion. Institucioni demonstroi ekzistencën e infrastrukturës mësimore, materiale e njerëzore për mbështetjen e këtij programi studimi. <i>Tabela 12/Plani Mësimor i lidhur me Personelin Akademik</i> <i>Tabela 16/Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë</i>			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në Financë Bankë janë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe të Departamentit të Shkencave Ekonomike, njësia ogruese për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Programet dhe sylabuset e lëndëve mësimore që janë pjesë e kurrikulës mësimore të programit të studimit Bachelor në Financë Bankë janë në përputhje me Udhëzimin e MAS Nr. 31, datë 15.11.2022 mbi kodifikimin e programeve te studimit. <i>Evidenca 1.5/Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</i> <i>Evidenca 1.7/Rregullore Departamenti i Shkencave Ekonomike</i> <i>Evidenca 1.8/Kodifikimi i Programeve të Studimit</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Departamenti i Shkencave Ekonomike i cili ofron programin e studimit Bachelor në Financë-Bankë ka bashkëpunim me departamentet e tjera të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe të Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Ky departament mbështet departamentet e tjera duke mbuluar disa lëndë mësimore të programeve të tjera të studimit të këtij Fakulteti, si dhe një pjesë të lëndëve të këtij program mbulohen nga pedagogë të departamenteve të tjera të të njëjtit fakultet. Ky bashkëpunim është materializuar me aplikimin për Ciklin e tretë Doktoratë në Shkenca Administrative. Njësitë bazë organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore dhe njësia kryesore koordinon aktivitetet e njërive bazë që përfaqëson. Njësitë administrative ofrojnë mbështetje me aktivitete të ndryshme siç janë Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e zhvillimit të kurrikulave, Zyra e marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Karrierës dhe Alumnit, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët. <i>Evidenca 1.9/Marrëveshje me Fakultetin e Shkencave Shoqërore</i> <i>Evidenca 1.4.a/Rregullore e AU</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Institucioni Albanian University për ofrimin e programeve të studimit ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm me qëllim shkëmbimin e eksperiencave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Këto marrëveshje janë të vlefshme edhe për realizimin e praktikave mësimore të studentëve, sipas programit të studimit që parashikon këtë lëndë. <i>Evidenca 1.10/Marrëveshje Bashkëpunimi</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Institucioni Arsimor Albanian University, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, dhe specifikisht Departamenti i Shkencave Ekonomike kanë nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me biznese vendase me qëllim kryerjen e praktikave profesionale nga ana e studentëve. Departamenti i Shkencave Ekonomike ka realizuar bashkëpunim në organizim konferencash shkencore me Universitetin Bujqësor të Tiranës, Universitetin e Korcës "Fan Noli" me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi dhe ka organizuar disa konferenca studentore. <i>Evidenca 1.10/Marrëveshje Bashkëpunimi</i> <i>Tabela 5 Institucionet dhe Organizatat Bashkëpunuese</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet	Departamenti i Shkencave Ekonomike, për programin e studimit Bachelor në Financë-Bankë ka hartuar raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.

e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Evidenca 1.12/Raport Analitik i Përfutimit të Marrëveshjeve			
Konkluzione	Institucioni i arsimit të lartë Albanian University siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1											
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.											
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi Bachelor në “Financë-Bankë” është organizuar në 180 kredite (ECTS), në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, nr. 80/2015 dhe aktet nënligjore në fuqi. Kurrikula dhe syllabuset e lëndëve që ofrohen në këtë program janë organizuar në përputhje me VKM nr.41 datë 24.01.2018 dhe udhëzimet e MAS. Emërtimi i programit ‘Bachelor në “Financë-Bankë” është në përputhje me nivelin 7 të kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Kohëzgjatja normale e studimeve në këtë program studimi është tre vite akademike (gjashtë semestra), të cilave u korrespondojnë 180 kredite ECTS. Programi i studimit përmban 32 ECTS në kategorinë e disiplinave të formimit të përgjithshëm (A); 97 ECTS në kategorinë e disiplinave karakterizuese (B); 25 ECTS në kategorinë e disiplinave ndërdisiplinore integruese (C); 20 ECTS parashikohen për praktikën profesionale (Lëndë plotësuese D) dhe 6 ECTS për punimin e tezës së diplomës (E). Tabela 9 <table border="1"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th><th>Kreditet</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td><td>32 ECTS</td></tr> <tr> <td>B</td><td>97 ECTS</td></tr> <tr> <td>C</td><td>25 ECTS</td></tr> <tr> <td>D</td><td>20 ECTS</td></tr> </tbody> </table>	Kategoria	Kreditet	A	32 ECTS	B	97 ECTS	C	25 ECTS	D	20 ECTS
Kategoria	Kreditet										
A	32 ECTS										
B	97 ECTS										
C	25 ECTS										
D	20 ECTS										

	<table><tr><td>E</td><td>6 ECTS</td></tr><tr><td>TOTAL</td><td>180 ECTS</td></tr></table>	E	6 ECTS	TOTAL	180 ECTS	<i>Evidenca 2.1/Kurrikula e Studimit BcH në Financë Bankë</i> <i>Evidenca 2.2/Syllabuset e Lëndëve</i> <i>Tabela 9/Plani Mësimor i ndarë sipas veprimtarisë formuese</i> <i>Tabela 10/Plani Mësimor sipas Kategorive dhe orëve</i> <i>Tabela 11/Ndryshimet në Planin Mësimor krahasuar me programet e liçensuara</i> <i>Tabela 14/Modeli i Syllabuseve sipas VKM-së</i>
E	6 ECTS					
TOTAL	180 ECTS					
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Objektivat e programit të Studimit Bachelor në Financë-Bankë janë të qarta, të justifikueshme dhe të arritshme. Programet e studimeve synojnë formimin e shprehive të veçanta në një larmi të gjerë profesionale e specialitetesh në fushën e financë-bankës. Në këtë aspekt programi i studimit Bachelor në “Financë-Bankë” synon që të realizojë një formim teorik dhe praktik me qasje globale të menaxhimit të aktiviteteve dhe sipërmarrjeve në vend. Programi i Studimit Bachelor në Financë-Bankë u ofron studentëve njohuri, të cilat do të jenë të nevojshme edhe për të ndjekur ciklet e tjera të studimit dhe në të njëjtën kohë t’u përgjigjet kërkesave me të cilat do të përballen të diplomuarit e këtij program studimi gjatë punësimit të tyre në të ardhmen. <i>Evidenca 1.5/Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</i> <i>Evidenca 1.7/ Rregullore Departamenti i Shkencave Ekonomike</i>					
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi i studimit Bachelor në Financë-Bankë ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. Kombinimi i lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese, i bën njohuritë e përftuara nga programi i studimit Bachelor në Financë-Bankë, përgjatë tre viteve akademike të aplikueshme dhe multi-disiplinore në fushat e financë-bankës. Programet e studimit zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe sfiduese në financë-bankë. <i>Evidenca 2.1/ Kurrikula e Studimit BcH në Financë Bankë</i> <i>Tabela 14/ Modeli i Syllabuseve sipas VKM-së</i> <i>Tabela 9/ Plani Mësimor i ndarë sipas veprimtarisë formuese</i>					
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e	Në kurrikulën/planin mësimor të programit të studimit Bachelor në Financë-Bankë, si dhe në rregulloren përkatëse janë shprehur qartë të gjithë elementët përshkrues të programit të studimit, të përcaktuara në					

praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	aktet ligjore dhe nënligjore. Për çdo lëndë/modul përcaktohen si më poshtë : 1. Ngarkesa përkatëse në kredite; 2. Format e ndryshme të mësimdhënies, 3. Ngarkesa në auditor dhe jashtë tij (orë në javë), 4. Kategoria të cilës i përket; Programi i Studimit Bachelor në Financë-Bankë përmban syllabuset sipas formatit të miratuar. Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera formuese janë të organizuara në 5 kategori, nga A deri tek E në përputhje me VKM 41, dt. 24.01.2018. Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, D, E janë lëndë të detyrueshme, ndërsa lëndët e kategorisë C janë lëndë ndërdisiplinore/integruese dhe me zgjedhje. Gjatë semestrit të dytë të vitit të dytë të studimeve, studenti përgatit edhe temën e diplomës, mbrojtja e së cilës është kusht i domosdoshëm për diplomim. Kohëzgjatja normale e këtij programi studimi është tre vite akademike dhe studenti që ndjek këtë program studimi duhet të përfitojë 180 kredite europiane ECTS (Tabela 9). <i>Evidenca 2.2/Syllabuset e Lëndëve</i> <i>Tabela 9/ Plani Mësimor i ndarë sipas veprimtarisë formuese</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Albanian University' nuk është Institucion i Arsimit të Lartë me status të veçantë.
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Bachelor në "Financë-Bankë" ka përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind, me programet e tjera që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë.
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet	Në përputhje me Udhëzimin e MAS Nr. 31, datë 15.11.2022 mbi kodifikimin e programeve të studimit, Institucioni Albanian University deklaron se është angazhuar në përgatitjen e kodifikimit dhe dorëzimin brenda afateve të përcaktuara. <i>Evidenca 1.8/Kodifikimi i Programeve të Studimit</i>



kodifikimi i lëndëve të programit.				
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Institucioni Arsimor Albanian University ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Universitete Ballkanike dhe Universitete të tjera publike dhe private në Shqipëri, si dhe institucione të tjera të rëndësishme në vend, me qëllim bashkëpunimin për shkëmbime stafi/studentësh, pjesëmarrje në projekte shkencore, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Është e nevojshme që marrëveshjet e bashkëpunimit të parashikojnë në mënyrë të veçantë krijimin e programeve të përbashkëta. Marrëveshjet e bashkëpunimit duhet të përkthehen në shkëmbime studentësh dhe stafi si dhe pjesëmarrje të përbashkëta në projekte shkencore e kërkimore. <i>Evidenca 1.10/Marrëveshje Bashkëpunimi</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në Financë Bankë i ofruar nga Albanian University organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi. Ky program është në përputhje me fushën e veprimtarisë së institucionit, dhe është organizuar në përputhje të plotë me VKM 41/2018. Përmbajtja e planit mësimor është e ngjashme së paku 70% me programe me të njëjtin emër të ofruara në IAL të tjera në vendin tonë. Programi i studimit jep njohuri në nivel të specializuar të financës dhe bankës, si dhe garanton punësimin dhe ekuivalentimin e studimeve për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Në kuadër të Programit të studimit Bachelor në “Financë-Bankë” gjatë vitit akademik 2023 – 2024 (Tabela 1), Departamenti i Shkencave Ekonomike ka në total 13 PAE, përkatësisht (1 Prof. Dr; 2 Prof. As; 6 Dr; 4 MsC) dhe 15 PAK (4 Prof. Dr; 3 Prof. As; 4 Dr; 4 MsC). Gjatë vitit akademik 2022-2023 (Tabela 1) ka patur në total 14 PAE (1 Prof. Dr; 2 Prof. As; 5 Dr; 6 MsC) dhe 19 PAK (4 Prof. Dr; 4 Prof. As; 6 Dr; 5 MsC). Gjatë vitit akademik 2021-2022 (Tabela 1) ka patur në total 13 PAE (1 Prof. Dr; 2 Prof. As; 5 Dr; 5 MsC) dhe 21 PAK (3 Prof. Dr; 5 Prof. As; 7 Dr; 6 MsC). Gjatë vitit akademik 2020-2021 (Tabela 1) ka patur në total 13 PAE (3 Prof. As; 5 Dr; 5 MsC) dhe 17 PAK (1 Prof. Dr; 6 Prof. As; 4 Dr; 6 MsC). Gjatë vitit akademik 2019-2020 (Tabela

6.1) ka patur në total 19 PAE (4 Prof. As; 7 Dr; 8 MsC) dhe 19 PAK (3 Prof. Dr; 4 Prof. As; 6 Dr; 6 MsC).

Departamenti i Shkencave Ekonomike, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Financë-Bankë përmbush kryesisht detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin (**Evidenca 2.4.a,b,c,d,e**). Raporti PAE/PAK ka qenë 50%/50% në vitin 2019-2020; 43%/57% në vitin 2020-2021; 38%/62% në vitin 2021-2022; 42%/58% në vitin 2022-2023 dhe 46%/54% në vitin 2023-2024. Ky raport duhet të jetë jo më pak se 70% PAE dhe jo më shumë se 30% PAK.

<i>Stafi I AU (2023- 2024)</i>	<i>MsC</i>	<i>Dr</i>	<i>Prof. As</i>	<i>Prof. Dr</i>	<i>Total</i>	<i>%</i>
<i>PAE</i>	4	6	2	1	13	46%
<i>PAK</i>	4	4	3	4	15	54%
<i>TOTALI</i>	8	10	5	5	28	100%
<i>Stafi I AU (2022- 2023)</i>	<i>MsC</i>	<i>Dr</i>	<i>Prof. As</i>	<i>Prof. Dr</i>	<i>Total</i>	<i>%</i>
<i>PAE</i>	6	5	2	1	14	42%
<i>PAK</i>	5	6	4	4	19	58%
<i>TOTALI</i>	11	11	6	5	33	100%
<i>Stafi I AU (2021- 2022)</i>	<i>MsC</i>	<i>Dr</i>	<i>Prof. As</i>	<i>Prof. Dr</i>	<i>Total</i>	<i>%</i>
<i>PAE</i>	5	5	2	1	13	38%
<i>PAK</i>	6	7	5	3	21	62%
<i>TOTALI</i>	11	12	7	4	34	100%
<i>Stafi I AU (2020- 2021)</i>	<i>MsC</i>	<i>Dr</i>	<i>Prof. As</i>	<i>Prof. Dr</i>	<i>Total</i>	<i>%</i>
<i>PAE</i>	5	5	3	0	13	43%
<i>PAK</i>	6	4	6	1	17	57%
<i>TOTALI</i>	11	9	9	1	30	100%
<i>Stafi I AU</i>	<i>MsC</i>	<i>Dr</i>	<i>Prof. As</i>	<i>Prof. Dr</i>	<i>Total</i>	<i>%</i>

	(2019-2020)						
	PAE	8	7	4	0	19	50%
	PAK	6	6	4	3	19	50%
	TOTALI	14	13	8	3	38	100%
Tabelat 1/Nr i Personelit Akademik për çdo njësi Evidenca 2.4/Ngarkesa e Personelit Akademik							
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Departamenti i Shkencave Ekonomike përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Financë-Bankë përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e programit të studimit si praktikatat mësimore, laboratorike e klinike, etj. Evidenca 4.3/CV Stafit akademik dhe ndihmës akademik						
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Departamenti i Shkencave Ekonomike për programin e studimit Bachelor në Financë Bankë ka caktuar një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Evidenca 2.5/Kordinatori i Programit të Studimit Evidenca 1.7/Rregullore e Departamentit të Shkencave Ekonomike						
Konkluzione	Njësia kryesore dhe Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kryesisht kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. Njësia bazë ka bërë përpjekje për të përmirësuar raportin PAE/PAK, por ende ky raport nuk është në përputhje me kriterin ligjor 70%/30%..						
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			
			X				

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Departamenti i Shkencave Ekonomike i cili ofron programin e studimit Bachelor në Financë-Bankë plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 25 të ligjit të nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Ky departament është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, i cili si i tillë plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 23 të Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Departamenti disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Ekonomike dhe të gjithë strukturat e departamentit kanë informacionin e nevojshëm mbi programin e studimit. Këto struktura janë vazhdimisht në koherencë me ndryshimet në legjislacionin në lidhje me strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit. <i>Ligji 80/215/Ligji i Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë</i> <i>Evidenca : 1.7 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i Studimit Bachelor në Financë-Bankë dhe Kurrikula e tij mësimore përmban informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në disiplina mësimore dhe aktivitetet të tjera formuese të organizuara në 5 kategori, nga A deri tek E në përputhje me VKM 41, dt. 24.01.2018. Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, D, E janë lëndë të detyrueshme, ndërsa lëndët e kategorisë C janë lëndë ndërdisiplinore/integruese dhe me zgjedhje. Gjatë semestrit të dytë të vitit të dytë të studimeve, studenti përgatit edhe temën e diplomës, mbrojtja e së cilës është kusht i domosdoshëm për diplomim. Kohëzgjatja normale e këtij programi studimi është tre vite akademike dhe studenti që ndjek këtë program studimi duhet të përfitojë 180 kredite europiane. <i>Evidenca 2.1/ Kurrikula e Studimit BcH në Financë Bankë</i> <i>Tabela 9/ Plani Mësimor i ndarë sipas veprimtarisë formuese</i> <i>Tabela 10/ Plani Mësimor sipas Kategorive dhe orëve</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Rregullorja e Studimeve e Institucionit AU përmban të gjithë detyrimet në lidhje me pranimet, transferimet dhe ekuivalentimin e studimeve. Në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në “Financë-Bankë” (Tabela 9), si dhe në syllabuset e lëndëve tregohet ngarkesa e studentëve në auditor dhe jashtë tij për çdo aktivitet formues. Frekuentimi/ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohen në rregulloren e programit të studimit. <i>Evidenca 1.4.a.b/Rregullore e AU</i> <i>Tabela 9/ Plani Mësimor i ndarë sipas veprimtarisë formuese</i>



	<i>Evidenca 2.2/Syllabuset e Lëndëve</i> <i>Evidenca 1.5/Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminar apo orë të laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit Bachelor në Financë-Bankë disponon të gjitha syllabuset e detajuara të çdo lënde, bazuar në planin mësimor, së bashku me gjithë informacionet e nevojshme lidhur me organizimin e tyre në leksione/seminare/ushtrime/detyra kurse, si dhe ngarkesën përkatëse brenda dhe jashtë auditorit, në përputhje me elementët e përcaktuar në shtojcën Nr. 2 të VKM Nr. 41, dt. 24/01/2018. <i>Syllabuset duhet të azhurnohen periodikisht me literaturë bashkëkohore si dhe literaturë shtesë të qartë, të përfshirë dhe udhëzuar me link, numër faqesh etj.</i> <i>Evidenca 2.2/ Syllabuset e Lëndëve</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Departamenti i Shkencave Ekonomike angazhohet periodikisht për përmirësimin e syllabuseve në përmbajtje dhe literaturë në përputhje me nevojat e tregut dhe zhvillimet më të fundit teknologjike. <i>Syllabuset e disa lëndëve mësimore paraqesin mungesë të detajeve informuese të studentëve si numri i faqeve, link-u për gjetjen e informacioneve online etj. Gjithashtu literatura e disa lëndëve është e vjetëruar (Lëndët e Investimeve, Kontabilitet Kosto-Drejtimit, Kontabilitet Financiar, Tregje dhe Institucione Financiare, Mikroekonomi, Makroekonomi etj).</i> <i>Evidenca 1.6/Procedurë rishikimi e syllabuseve</i>			
Konkluzione	Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë. Syllabuset e lëndëve mësimore pjesërisht kanë nevojë për azhurnim të literaturës bazë me botime bashkëkohore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënies dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe	Programi i studimit Bachelor në "Financë-Bankë", ka për qëllim përgatitjen teoriko - praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit si menaxher në institucione biznesi, organizata jofitim-prurëse,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	administratë lokale, duke kontribuar në drejtim të analizës së faktorëve, riskut dhe mundësive për institucionet e sipërpërmendura. Kjo përgatitje synon t'iu përgjigjet kërkesave të kohës duke eliminuar përgatitjen e specialistëve me kompetencë të kufizuar, sespe programi studimit shtrin hapësirën e specializimit, tejkalon kufijtë tradicionalë midis shkencave duke afruar një trajtim ndërdisiplinor dhe multishkencor. <i>Evidenca 1.5/ Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</i> <i>Evidenca 1.7/Rregullore e Departamentit të Shkencave Ekonomike</i>														
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Plani mësimor i Programit të studimit Bachelor në Financë-Bankë ka në përmbajtje lëndët të cilat janë shpërndarë dhe kombinuar përgjatë vitit dhe semestrave në mënyrë që formimi i studentëve të jetë gradual, duke mundësuar në fund të studimit aftësimin e tyre, në përputhje me kërkesat e tregut të punës në fushën përkatëse. <i>Tabela 9/ Plani Mësimor i ndarë sipas veprimtarisë formuese</i>														
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Financë-Bankë” është organizuar në përputhje me modele të ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare të kësaj fushe, me raporte midis njohurive teorike, ushtrimeve/seminareve, detyrave të kursit dhe praktikës, të tilla që ta përgatisë studentin sa më pranë nevojave konkrete të tregut të punës. <i>Evidenca 2.3/Studimi i Tregut të Punës</i>														
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi i studimit Bachelor në Financë-Bankë bazuar në rregulloren e DSHE ka parashikuar në veprimtaritë formuese ndarjen si më poshtë (Tabela 13): <table border="1" data-bbox="630 1377 1236 1691"> <thead> <tr> <th>Elementë</th><th>Ngarkesa (Orë)</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Leksione</td><td>945</td></tr> <tr> <td>Seminare</td><td>247.5</td></tr> <tr> <td>Ushtrime</td><td>578</td></tr> <tr> <td>Praktikë mësimore</td><td>100</td></tr> <tr> <td>Provim formimi/temë diplome</td><td>12</td></tr> <tr> <td>Total</td><td>1882.5</td></tr> </tbody> </table> Njohuritë e marra gjatë studimeve në këtë program studimi, i mundësojnë studentit vazhdimin e studimeve në programe Master, si dhe punësimin e tij në përputhje me fushën e studimit në ente publike dhe private kombëtare dhe ndërkombëtare. <i>Tabela 13/Ngarkesa Totale e Studentëve në Auditor</i>	Elementë	Ngarkesa (Orë)	Leksione	945	Seminare	247.5	Ushtrime	578	Praktikë mësimore	100	Provim formimi/temë diplome	12	Total	1882.5
Elementë	Ngarkesa (Orë)														
Leksione	945														
Seminare	247.5														
Ushtrime	578														
Praktikë mësimore	100														
Provim formimi/temë diplome	12														
Total	1882.5														



	<i>Evidenca : 1.4.a Rregullore e përgjithshme AU</i> <i>Evidenca: 1.7 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike.</i>			
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përpunje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Departamenti i Shkencave Ekonomike angazhohet në përmirësimin e syllabuseve në përmbajtje dhe literaturë çdo vit akademik, në përpunje me nevojat e tregut dhe zhvillimet më të fundit teknologjike. Biblioteka e Departamentit përditësohet dhe pasurohet në vazhdimësi në funksion të azhormimeve përkatëse të syllabuseve. <i>Ka mungesë të disa titujve të librave bashkëkohorë dhe ribotimeve të fundit të librave në përdorim nga ana e Lektorëve.</i> <i>Evidenca 1.6/ Proçedurë rishikimi e syllabuseve</i> <i>Evidenca 1.7/ Rregullore e Departamentit të Shkencave Ekonomike</i>			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi i studimit Bachelor në Financë-Bankë, synon t'iu ofrojë studentëve njohuri të thelluara të mbështetura në lëndë të formimit bazë të karakterit shkencor si dhe njohuri që përkojnë me profilin e diplomës Bachelor në "Financë-Bankë". Përgatitja e temës së diplomës dhe praktika mësimore aftësojnë studentin me njohuri specifike për të ekspertëve të aftë për të operuar në këtë fushë, por edhe për t'u integruar në institucione me karakter specifik në fushën përkatëse <i>Tabela 23/Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve</i> <i>Evidenca : 3.12.a Model i Diplomës Bachelor në "Financë-Bankë".</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit Bachelor në Financë-Bankë, ka për qëllim t'iu ofrojë studentëve njohuri, të cilat do të jenë të nevojshme edhe për të ndjekur ciklet e tjera të studimit dhe në të njëjtën kohë t'u përgjigjet kërkesave, me të cilat ata do të përballen gjatë realizimit të studimeve të tyre të mëtejshme. Në përfundim të Programit të studimit Bachelor në "Financë-Bankë", studentët zotërojnë kapacitetet analitike dhe konceptet e nevojshme për të trajtuar problematikat e administrimit pasi janë pajisur dhe me shprehje të veçanta të lidhura me fushën përkatëse të studimit. <i>Evidenca 2.4/Ngarkesa e Personelit Akademik</i> <i>Evidenca 1.2/Rregullore e Programit të Studimit BsC në Financë Bankë</i>			
Konkluzione	<i>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5


Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-13123

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Departamenti i Shkencave Ekonomike ka në përbërje pedagogë që punojnë në biznese të rëndësishme në vend si dhe në institucione bankare apo administratë duke qenë në këtë mënyrë urë lidhëse me kërkesat e tregut potencial të punës. Nëpërmjet mbledhjeve të departamentit pedagogët shprehin opinionet e organizatave që përfaqësojnë dhe sugjerojnë përfshirjen në syllabuse të disa temave që pajisin studentët me dije të aplikueshme. Përfaqësues të institucionit marrin pjesë në panairë të punës dhe biznesit për t'u konsultuar, rakorduar dhe përmirësuar programet e studimit sipas kërkesave të tregut të punës për kualifikimin e profesionistëve dhe të punësuarit e programeve të tij. <i>Evidenca 5.3/Panairi Work&Study</i> <i>Evidenca 5.7/Leksion i hapur për nxitjen e studentëve për punësim</i> <i>Evidenca 6.8/Raport Semestral Departamenti</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Departamenti i Shkencave Ekonomike në procesin e përmirësimit të programeve të studimit, përfshihen edhe sugjerimet, kërkesat dhe pritshmëritë e studentëve qoftë përmes raporteve të Njësisë Bazë, qoftë përmes pyetësorëve vlerësues të kryer nga NJSBC çdo semester akademik por edhe përmes fokus-grupeve të targetuara. <i>Evidenca 1.6/Procedurë rishikimi e syllabuseve</i> <i>Evidenca 6.8/ Raport Semestral Departamenti</i> <i>Evidenca 6.9/Rezultatet e Pyetësorit të Studentëve</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Personeli akademik i Departamentit të Shkencave Ekonomike inkurajohet nga institucioni të marrë pjesë në shoqata, komitete, borde, ku diskutohen të rejat e fundit të profesionit në fushat e financës dhe bankës. Personeli akademik sugjeron leksione të hapura me tema të interesit shkencor dhe lektorë të spikatur të fushës (Evidenca 2.7) Personeli angazhohet në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. <i>Evidenca 1.9/Marrëveshje me Fakultetin e Shkencave Shoqërore</i> <i>Evidenca 1.10/Marrëveshje Bashkëpunimi</i> <i>Evidenca: 2.7 Leksione të hapura.</i>
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe</i>




	<i>përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët/ushtrimet, detyrat e kursit, projekte, praktika dhe tema e diplomës. Lëndët klasifikohen në dy grupe kryesore: lëndë të detyruara dhe lëndë me zgjedhje. Lëndët organizohen në pesë kategori disiplinash. Në programin Bachelor në Financë-Bankë procesi i mësimdhënies zbatohet sipas syllabusit të çdo lënde dhe në liri të plotë të personelit akademik. Ngarkesa mësimore në leksione e seminare për studentët realizohet konform udhëzimeve të nxjerra nga MAS në zbatim të legjislacionit. Personeli akademik organizon procesin mësimor në komponentët e shprehur në syllabus. Personeli akademik përdor mjetet didaktike si raste studimore, slide, tekste shtesë, urdhëresa e botime ligjore sipas rastit si dhe teknologjinë e vendosur në auditore – PC dhe Video - projektorë për të zhvilluar dijet e studentëve. Kontrolli i njohurive realizohet sipas metodologjisë së përshkruar në syllabusin e lëndës ku personeli akademik plotëson të gjitha komponentët me pikët përkatëse. Kontrolli i njohurive të studentëve përcaktohet në Rregulloren mësimore të programit të studimit dhe në syllabusin e çdo lënde. <i>Evidenca 2.1/ Kurrikula e Studimit BcH në Financë Bankë</i> <i>Tabela 14/Modeli i Syllabuseve sipas VKM-së</i> <i>Evidenca 1.5/Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma,	Institucioni Albanian University angazhon të gjithë personelin akademik, ndihmës akademik, mësimor dhe administrativ në përputhje me objektivat e programit të studimit Bachelor në “Financë-Bankë” dhe arritjen e tyre dhe duke shfrytëzuar karakteristikat akademike dhe

mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	personale më cilësore të personelit të përfshirë në zhvillimin e këtij programi. Personeli akademik i grupuar sipas grup-lëndëve të programit mësimor diskuton dhe reflekton në përditësimin e syllabuseve, të literaturës dhe metodave të mësimdhënies. Personeli akademik sugjeron leksione të hapura me tema të interesit shkencor dhe lektorë të spikatur të fushës. Personeli angazhohet në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. <i>Evidenca 1.2/Rregullore e Programit BsC Financë Bankë</i> <i>Evidenca 1.7/Rregullore Departamenti i Shkencave Ekonomike</i> <i>Evidenca 1.6/Procedurë rishikimi e syllabuseve</i> <i>Evidenca 2.7/Strategjia e Zhvillimit të AU</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Departamenti Shkencave Ekonomike ka në dispozicion laboratorin e Informatikës ku zhvillohet lënda e Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit. Pedagogu i lëndës kujdeset për realizimin e orëve të seminarit në këtë laborator. Software Finance 5 i instaluar ne PC e këtij Laboratori ndihmon studentët për disa nga lëndët e Financës e Kontabilitetit. <i>Evidenca R2/Përmirësimi i ambjenteve të AU</i> <i>Evidenca 4.8/Procedurë e pasurimit të bibliotekës</i> <i>Evidenca 4.7/Titujt e librave në bibliotekë</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar pranë Departamentit të Shkencave Ekonomike të AU është i angazhuar në përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies duke iu përgjigjur kështu nevojave të ndryshme të studentëve. Personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Çdo fillim viti akademik, NJSBC organizon trajnime për stafin akademik , kryesisht atë të ri të rekrutuar, në kuadër të mësimdhënies me qëllim përmirësimin e kompetencave të tyre në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. <i>Evidenca 3.5/Shembull Raporti semestral pedagogu</i> <i>Evidenca 4.1/Kontrata PAE</i> <i>Evidenca 6.3/Pedagogët përgjegjës për sigurimin e cilësisë</i> <i>Evidenca 3.1/Axhenda e trajnimeve të stafit akademik</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë	Departamenti Shkencave Ekonomike vlerëson format dhe metodat e mësimdhënies. Ato janë në vlerësim të vazhdueshëm nga vetë personeli akademik dhe Institucioni. Vëmendje e veçantë ju kushtohet sugjerimeve që vinë nga vetë studentët në pyetsorët e plotësuar apo fokus grupet me qëllim rritjen e nivelit të mësim-nxënies dhe përmirësimin e rezultateve përfundimtare të studentëve.



studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Krahas tyre, stafi akademik angazhohet në nxitjen e studentëve në mësim-nxënie përmes përdorimit të platformave të edukimit online, si Microsoft Teams ku studentëve ju vihen në dispozicion materiale të ndryshme mësimore, teste vetë-vlerësuese, detyra kursi etj. Studentët shprehin mendimet e tyre mbi procesin mësimor dy herë në vit, në fund të çdo semestri, përmes pyetësorëve të organizuar online në Microsoft Forms duke ruajtur anonimitetin. <i>Evidenca 6.7/Shkresë Fokus Grupe</i> <i>Evidenca 3.3/Shembull pyetësori i plotësuar</i> <i>Evidenca 3.4/Manuali i përdorimit të platformës Teams</i> <i>Evidenca 6.9/Rezultatet e Pyetësorit</i>			
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Institucioni Albanian University organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. <i>Evidenca 6.2/Vendim Senati për krijimin e komisioneve</i> <i>Evidenca 6.3/ Pedagogët përgjegjës për sigurimin e cilësisë</i> <i>Evidenca 3.1/ Axxhenda e trajnimeve të stafit akademik</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm): • Provimi përfundimtar 60 pikë (60%), • Provimi i ndërmjetëm 20 pikë (20%), • Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive në seminare, detyra/projekte kursi 20 pikë (20%). <i>Evidenca 1.4/Rregullore e përgjithshme e AU</i> <i>Tabela 15/Format e kontrollit të njohurive</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët e Programit të Studimit Financë Bankë informohen për mënyrat e kontrollit të dijes në orën e parë të çdo moduli (lënde mësimore) përveç ditës informuese që organizohet çdo fillim viti akademik nga Përgjegjësi i departamentit. Kontrolli i dijes bëhet me gojë, me shkrim, me detyra kursi, me projekte kursi ose me shkrim dhe me gojë. Kjo vlen si për provimet, ashtu edhe për testimet apo seancat e kontrollit që mund të organizohen gjatë semestrit ose gjatë vitit. Tezat e provimeve përfundimtare sekretohen me barkode, të cilat pas korigjimit nga pedagogut të lëndës, ç'sekretohen në Departament. <i>Evidenca 5.8/Axhenda e javës orientuese</i> <i>Evidenca 2.2/Sylabuse</i> <i>Evidenca 1.7/Rregullore Departamenti i Shkencave Ekonomike</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm. • Provimi përfundimtar 60 pikë (60%), • Provimi i ndërmjetëm 20 pikë (20%), Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive në seminare, detyra/projekte kursi 20 pikë (20%). <i>Evidenca 1.5/Rregullore Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</i> <i>Tabela 15/Format e kontrollit të njohurive</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Departamenti i Shkencave Ekonomike realizon kontrollin e dijes me gojë përmes aktivizimit në seminare, me shkrim, me detyra kursi, me projekte kursi ose me shkrim dhe me gojë. Kjo vlen si për provimet, ashtu edhe për testimet apo seancat e kontrollit që mund të organizohen gjatë semestrit ose gjatë vitit. Në sallën e provimit janë prezentë 2 pedagogë (monitorues) përgjegjës për zbatimin e rregullave të miratuara për procesin e zhvillimit të provimit dhe për çdo vendimarrje që lidhet me mbarëvajtjen e këtij procesi. Pedagogët monitorues janë lektori i lëndës dhe asistent – lektori i grupit përkatës. Në rastet kur nuk ka një të tillë, pedagogu i dytë monitorues është një pedagog tjetër me profil të

	afërt me lëndën. Tezat e provimeve përfundimtare sekretohen me barkode, të cilat pas korigjimit nga pedagogët e lëndës, ç' sekretohen në Departament. <i>Evidenca 1.5/ Rregullore Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</i> <i>Evidenca 3.13/Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>			
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Kontrolli i njohurive të studentëve përcaktohet në Rregulloren mësimore të programit të studimit dhe në syllabusin e çdo lënde. Për të ruajtur objektivitetin e vlerësimit, forma e kontrollit në program është me shkrim dhe e sekretuar. Secili nga studentët gjatë sezonit të provimit është i regjistruar në sistem me një bar-kod dhe dekodimi i tij bëhet vetëm pasi është korrigjuar fleta e provimit dhe vlerësuar me pikët përkatëse. Forma e vlerësimit realizohet në përputhje me vendimet e Senatit të Albanian University. Formula e vlerësimit të studentëve për çdo lëndë është e prezantuar në syllabusin e lëndës. Në fillim të çdo semestri pedagogët iu bëjnë të ditur studentëve modelin dhe formulën e kontrollit të njohurive të tyre përgjatë semestrit dhe në fund të tij. Vlerësimi i studentëve bëhet me pikë dhe gërmë. Vlerësimi i mësimdhënies kryhet nga Departamenti dhe NJSBC nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme. Është e detyrueshme që nga ana e çdo pedagogu dhe nga ana e vetë departamentit të bëhet një raport semestral (raport tip) në lidhje me cilësinë e mësimdhënies. Në fund të semestrit realizohet anketa e studentit ku vlerësohet personeli akademik sipas disa kriterëve të përfshira në pyetësorin e vlerësimit. Përfaqësuesit e studentëve janë të pranishëm në mbledhjet e departamentit, në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit dhe në komisionet e përhershme Ata gjithashtu shprehin mendimet dhe kërkesat e tyre edhe përmes përfaqësuesve në Këshillin Studentor. Kryetari i Këshillit Studentor është pjesë e Senatit Akademik. <i>Evidenca 1.5/ Rregullore Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</i> <i>Evidenca 2.1/Kurrikula e studimit në Bachelor në Financë Bankë</i> <i>Evidenca 2.2/ Syllabuse</i> <i>Evidenca 3.5/Shembull raporti semestral pedagogu</i> <i>Evidenca 3.6/Anëtarët e komisioneve të përhershme</i>			
Konkluzione	Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (0) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Pedagogët e Departamentit të Shkencave Ekonomike të Albanian University realizojnë kontrollin e njohurive me gojë, me shkrim, me detyra kursi, me projekte kursi ose me shkrim dhe me gojë. Kjo vlen si për provimet, ashtu edhe për testimet apo seancat e kontrollit që mund të organizohen gjatë semestrit ose gjatë vitit. Tezat e provimeve përfundimtare sekretohen me barkode, të cilat pas korigjimit nga pedagogu i lëndës, ç'sekretohen në Departament. <i>Evidenca 3.13/Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidenca 1.2/Rregullore e Programit Bachelor në Financë Bankë</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Pedagogët e Departamentit të Shkencave Ekonomike të Albanian University në lidhje me procesin e provimeve me shkrim konfirmohet se ruhet anonimiteti, përmes sekretimit të provimeve. Pas korigjimit, provimet depozitohen pranë departamentit ku bëhet ç'sekretimi i tezës. Vlerësimi i provimeve bëhet i njohur studentëve nëpërmjet sekretarisë mësimore të programit të studimit përkatës. Teza e provimit duhet të përmbajë përveç vlerësimit dhe firmën e pedagogut apo pedagogëve që e kanë korigjuar. <i>Evidenca 3.13/Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Korigjimi i provimeve bëhet nën përgjegjësinë e një pedagogu titullar brenda 7 ditësh nga dita e përfundimit të provimit. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të vlerësimit të provimit të ndërmjetëm, provimit përfundimtar, angazhimit të studentit në seminare dhe laboratore, si dhe cilësia e detyrës së kursit të dorëzuar për lëndët, që e parashikojnë një të tillë. Pikëzimi sipas këtyre elementëve i bëhet i ditur studentëve të interesuar nga sekretaria mësimore. <i>Evidenca 3.13/Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidenca 1.2/Rregullore e Programit Bachelor në Financë Bankë</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Pedagogët e Departamentit të Shkencave Ekonomike të Albanian University përmes metodave të ndryshme të vetëvlerësimit të studentëve, nxisin procesin e vetë-nxënies tek studentët (p.sh. quiz-e, detyra, ushtrime etj.). <i>Evidenca 3.13/Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidenca 1.2/Rregullore e Programit Bachelor në Financë Bankë</i>

Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Pedagogët e Departamentit të Shkencave Ekonomike të Albanian University gjatë provimit nuk lejojnë përdorimin e materialeve që gjykojnë të papërshtatshme nga pedagogu i lëndës përkatëse, i cili përpara fillimit të provimit ose në tezën e provimit citon materialet që lejohen të përdoren gjatë kohës së zhvillimit të provimit. Përsa i përket temave të diplomave, pas përzgjedhjes nga ana e studentit, në bashkëpunim me udhëheqësin, departamenti bën kontrollin e saj në database-n e departamentit. Personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. <i>Evidenca 3.7/Lista e Temave të Diplomës</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Pedagogët e Departamentit të Shkencave Ekonomike të Albanian University realizojnë korrigjimin e provimeve nën përgjegjësinë e një pedagogu titullar brenda 7 ditësh nga dita e përfundimit të provimit. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të vlerësimit të provimit të ndërmjetëm, provimit përfundimtar, angazhimit të studentit në seminare dhe laboratorë, si dhe cilësia e detyrës së kursit të dorëzuar për lëndët, që e parashikojnë një të tillë. Pikëzimi sipas këtyre elementëve i bëhet i ditur studentëve të interesuar nga sekretaria mësimore. Me përdorimin e sekretarisë online Pitagora studentët njihen për rezultatet e provimeve përmes tij, në mënyrë individuale. <i>Evidenca 3.8/Manual i përdorimit të Pitagorës</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Bazuar në rregulloren e studimeve, studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korrigjimit pasi të bëhet edhe ç'sekretimi i tyre. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë, si dhe me pikët në çdo rubrikë. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorigjuara apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të programit të studimit përkatës, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve. <i>Evidenca 1.2/Rregullore e Programit BsC Financë Bankë</i> <i>Evidenca 1.4.a/Rregullore e AU</i> <i>Evidenca 1.7/Rregullore e Departamentit të Shkencave Ekonomike</i> <i>Evidenca 3.13/Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Pas reklamimit të provimit nga ana e studentit, Dekani i Fakultetit përkatës ngre një komision ad hoc në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë edhe pedagogët, të cilët kanë korigjuar provimet. Vendimi lidhur me rivlerësimin e provimit merret brenda një jave nga dita e depozitimit të ankesës dhe i bëhet i njohur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore. Vendimi i bashkëlidhet proces-verbalit të provimit (fletës së provimit). <i>Evidenca 1.4/Rregullore e AU</i>

Konkluzione	Rregullorja e programit të studimit parashikon të gjitha procedurat që lidhen me vlerësimin e studentëve, procedurën e ankimimit dhe rishikimit të vlerësimit, si edhe vlerësimin përfundimtar të studentëve. Njësia përgjegjëse dhe personeli akademik monitorojnë me rigorozitet dhe përpiqen që të eliminojnë kopjimin dhe plagjiaturën. Procedura e parashikuar dhe e ndjekur për vlerësimin, kombinohet edhe me metoda elektronike të vlerësimit (Clean Score) duke garantuar një rezultat të drejtë dhe të paanshëm për vlerësimin e studentit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Personeli akademik përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Financë-Bankë” angazhohet për përmirësimin dhe nxitjen e mësimnxënies tek studentët dhe përgatitjen e tyre sipas kërkesave të tregut të punës. Programi i studimit garanton thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. <i>Evidenca 1.2/ Rregullore e Programit BsC Financë Bankë</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Institucioni Albanian University në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies, ka ngritur strukturat përkatëse, të cilat janë: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, si dhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin. Detyrat e kursit, që zhvillohen gjatë gjithë ciklit Bachelor, nxisin krijimin e aftësive komunikuese dhe ndërvepruese të studentit, i cili do të jetë i aftë të prezantojë projektet e zhvilluara prej tij përmes raporteve dhe prezantimeve në ppt. Në dispozicion të studentëve është laborator i kompjuterëve. <i>Evidenca 1.2/ Rregullore e Programit BsC Financë Bankë</i> <i>Evidenca R2/Përmirësimi i kapaciteteve infrastrukturore</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton	Gjatë orëve të fundit të mësimin, studentët dorëzojnë detyrat e kursit, punët e laboratorëve, apo zhvillojnë seanca përmbledhëse ushtrimesh, përmes të cilave testojnë njohuritë e marra dhe vetë-vlerësojnë përgatitjen e tyre përpara provimit përfundimtar. Në fund të çdo semestri, stafi akademik harton raportin semestral, në të cilin raporton për realizimin e objektivave të mësimdhënies. <i>Evidenca 3.5/ Shembull raporti semestral pedagogu</i>

studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.				
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Personeli akademik i angazhuar pranë Departamentit të Shkencave Ekonomike ofron një mësimdhënie që ndërthur njohuritë teorike të dhëna drejtëpërdrejtë gjatë leksioneve dhe seminareve me ato praktike, përmes diskutimit të rasteve studimore dhe praktikave më të mira të sjella nga fusha e biznesit bankar. Krahas tyre, personeli akademik angazhohet në nxitjen e studentëve në mësimnxënie përmes detyrave të kursit për çështje të reja innovative në lëmin e biznesit, diskutimeve të rasteve në orët e seminareve, leksioneve të hapura dhe ekspertëve të ftuar në nivel Departamenti apo Universiteti. Format dhe metodat e mësimdhënies janë në vlerësim të vazhdueshëm nga vetë personeli akademik dhe Institucioni. Vëmendje e veçantë ju kushtohet sugjerimeve që vinë nga vetë studentët në pyetësorët e plotësuar apo focus grupet, me qëllim rritjen e nivelit të mësimnxënies dhe përmirësimin e rezultateve përfundimtare të studentëve. <i>Evidenca 6.9/Rezultatet e Pyetësorit</i> <i>Evidenca 6.7/Shkresë fokus-grupe</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik i angazhuar pranë Departamentit të Shkencave Ekonomike Efektiv apo me Kontratë ka në fokus zhvillimin e Leksioneve të Hapura për afrimin e përgatitjes teorike të studentëve me eksperiencën praktike në tregun e punës. <i>Evidenca 5.6/Leksion i hapur</i> <i>Evidenca 5.7/Leksion i hapur</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</i>			
Shkalla e përmbylljes së standardit	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm: • Provimi përfundimtar 60 pikë (60%), • Provimi i ndërmjetëm 20 pikë (20%), • Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive në seminare, detyra/projekte kursi 20 pikë (20%). Në rregulloren e studimeve të programit të studimit përcaktohet procedura e dhënies së provimit të formimit me temë diplome. <i>Evidenca 1.5/ Rregullore Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</i> <i>Tabela 15/ Format e kontrollit të njohurive</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Studentëve ju vihet në dispozicion baza e të dhënave me pyetjet e provimit të formimit, të cilat janë hartuar nga pedagogët e lëndëve përkatëse, të shtjelluara gjatë zhvillimit të lëndës. Studentët informohen për mënyrat e kontrollit të dijes në lidhje me provimin final apo testimin përmes mbrojtjes së diplomës me gojë. <i>Evidenca 3.8/Manual i përdorimit të Pitagorës</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Tezat e provimeve përfundimtare sekretohen me barkode, të cilat pas korigjimit nga pedagogu/ët e lëndës, ç'sekretohen në Departament. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. <i>Evidenca 1.2/ Rregullore e Programit BsC Financë Bankë</i> <i>Evidenca 1.4/ Rregullore e AU</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Diploma Bachelor në "Financë-Bankë" mbrohet me provim ose me punim (tezë) diplome. Brenda një muaji nga data e fillimit të vitit akademik, Përgjegjësi i Departamentit u bën të njohur studentëve, të cilët diplomohen atë vit, listën e temave të gjera të diplomave, me anën e të cilave do të bëhet vlerësimi përfundimtar. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. Pedagogët udhëheqës përzgjidhen nga studentët mes një liste të hartuar nga Drejtuesi Departamentit ku listohen sipas kriterit të gradës shkencore dhe ekspertizës me fushën e studimit. Punimet më të mira janë prezantuar edhe në Konferenca studentore apo Kombëtare, si dhe janë publikuar në faqen zyrtare të AMF. Disa punime janë çuar më tej nga studentë e pedagogë të DSHE për t'u botuar në revistën "Optime".

	<i>Evidenca 3.9/Fondi i pyetjeve dhe literatura mbështetëse për provimin e formimit</i> <i>Evidenca 3.10/Manual i punimit të temës së diplomës</i> <i>Evidenca 3.11/Kryetar i këshillit studentor</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Studentët e këtij programi studimi nuk kryejnë matje, analiza apo testime laboratorike për shkak të natyrës së studimeve në Financë-Bankë që nuk parashikojnë orë dhe eksperiencë të tilla.			
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. <i>Evidenca 1.2/ Rregullore e Programit BsC Financë Bankë</i> <i>Evidenca 1.4/ Rregullore e AU</i>			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën, suplementin e diplomës, si dhe listën e notave të lëshuara nga Albanian University dhe të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit në Republikën së Shqipërisë. Në përfundim të studimeve, studenti merr një kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar si dhe plan-programet e plota për secilën kurrikul sipas kërkesës së tij. <i>Evidenca 3.12/Model i diplomës</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sekretaria mësimore e programit të studimit Bachelor në Financë-Bankë, kryesekretarja e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike si dhe Administratori i përgjithshëm i Albanian University menaxhojnë dhe administrojnë të gjithë informacionin e studentëve ndër vite. Të gjitha të dhënat e studentëve që nga fillimi i studimeve deri në diplomimin e tyre gjenden në data bazat e sekretarisë mësimore si dhe në regjistrin themeltar të notave. Sekretaria mësimore arkivon dhe mban në dosje dokumentet e çdo studenti që është i regjistruar, është i çregjistruar si dhe të studentëve që kanë mbaruar studimet e tyre. <i>Evidenca 3.13/Rregullore e sekretarisë mësimore</i>			
Konkluzione	Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Departamenti i Shkencave Ekonomike (DSHE) është përgjegjësi kryesor për zhvillimin e këtij programi, dhe stafi akademik përbëhet kryesisht nga anëtarët e këtij departamenti. Në varësi të fokusit të lëndëve specifike, në mësimdhënie përfshihet gjithashtu personel akademik nga departamente të tjera brenda Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike (FSHAE). Nga analiza e dokumentacionit rezulton se, gjatë periudhës 2019-2024, programi i ciklit të parë Bachelor në “Financë-Bankë” nuk ka pasur një mbulim të qëndrueshëm nga një trupë akademike e organizuar, siç tregojnë edhe të dhënat e RVB dhe tabelat përmbledhëse nr. 6.1; 6.2; 6.3; 6.4; si dhe 6.5 për raportin në përqindje midis PAE dhe PAK.										
	Kualifikimi i stafit akademik	2019-2020		2020-2021		2021-2022		2022-2023		2023-2024	
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof. Dr	0	3	0	0	0	1	1	1	1*	0
	Prof. Asoc.	2	0	3	1	2	1	2	1	2	1
	Dr/Phd	5	2	6	2	5	4	6	4	5	3
	Dr/Phd në proces	4	0	1	1	1	0	2	0	2	0
	MSc	5	3	5	3	3	2	3	4	3	4
	Gjithsej	16	8	15	7	11	8	14	10	13	8
	Në vitin akademik aktual 2023-2024 (pas konfirmimeve të bëra edhe gjatë vizitës në institucion), në program janë të angazhuar 13										

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-13123

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	(trembëdhjetë) PAE, ku 1 (një) prej tyre ka gradën shkencore "Prof.Dr, 2 (dy) janë me gradën "Prof Asoc Dr", 5(pesë) kanë gradën "Doktor", 2 (dy) janë në proces doktorature dhe 3 (tre) kanë titullin "Master Shkencor". Numri i PAK për këtë vit është 8 (tetë) anëtarë, nga të cilët 1 (një) mban titullin akademik "Prof. Asoc.", 3 (tre) kanë gradën "Doktor", dhe 4 (katër) kanë titullin "Master Shkencor". Bazuar në CV-të e stafit akademik që mbulojnë këtë program studimi, konstatohet se plotësohen kërkesat ligjore për kualifikimin e stafit në fushën e programit të studimit. Rekomandohet që institucioni të rrisë numrin e PAE-së, pasi vërehet se stafi nuk ka pasur qëndrueshmëri në 5 (pesë) vitet e fundit. <i>*(larguar Prof.Dr E.Mece), në tabelat përmbledhëse ishte vënë numër 2(dy).</i> <i>Evidenca: Tabelat përmbledhëse aneks RVB 6.1; 6.2; 6.3; 6.4; 6.5.</i> <i>Evidenca: 2.4.a,b,c,d,e Ngarkesa e personelit akademik</i>												
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga verifikimi i të dhënave statistikore të RVB rezultojnë të përmbledhura mbulimet e ngarkesave mësimore të PAE/PAK. Shikohet një trend në rritje të këtij raporti duke rekomanduar që të ketë një rritje dhe qëndrueshmëri të stafit PAE. <table><tr><td>Raporti PAE/PAK</td><td>2019-2020</td><td>2020-2021</td><td>2021-2022</td><td>2022-2023</td><td>2023-2024</td></tr><tr><td></td><td>67%/33%</td><td>68%/32%</td><td>58%/42%</td><td>58%/42%</td><td>62%/38%</td></tr></table> Përsa i takon raportit mesatar PAE/PAK për vitin akademik 2023-2024 është 62%/38%. <i>Evidenca: Tabelat përmbledhëse aneks RVB 6.1; 6.2; 6.3; 6.4; 6.5.</i> <i>Evidenca: 2.4.a,b,c,d,e Ngarkesa e personelit akademik</i>	Raporti PAE/PAK	2019-2020	2020-2021	2021-2022	2022-2023	2023-2024		67%/33%	68%/32%	58%/42%	58%/42%	62%/38%
Raporti PAE/PAK	2019-2020	2020-2021	2021-2022	2022-2023	2023-2024								
	67%/33%	68%/32%	58%/42%	58%/42%	62%/38%								
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me	Sipas të dhënave të RVB-së së institucionit dhe dokumentacionit të aplikimit për akreditimin e programit, është vënë re se në vitet e fundit ka munguar stabiliteti i personelit akademik të angazhuar në këtë program. Nga verifikimet e kryera nga GJVJ pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, rezulton se PAE dhe PAK janë të punësuar me kontrata pune, të cilat përfshijnë detyrimet e ndërsjella për kontributet në sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. <i>Evidenca; 4.1.a,b Kontrata PAE , Kontrata PAK</i>												

sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Procesi i rekrutimit për stafin akademik dhe ndihmës në bazohet në rregulloren e institucionit dhe udhëzimet specifike në nivelin institucional dhe të njësive përkatëse. Për programin e ciklit të parë Bachelor në "Financë-Bankë", stafi akademik është përzgjedhur në përputhje me procedurat e parashikuara nga kuadri rregullator i institucionit dhe në përputhje me ligjin e ri për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë (RSH). Departamentit i Shkencave Ekonomike (DSHE), identifikon nevojat për staf bazuar në ngarkesën mësimore dhe numrin e studentëve të planifikuar, përgatit kriteret për rekrutim dhe, pas miratimit nga dekani i fakulteti, këto kriterë publikohen në faqen zyrtare të universitetit. Aplikimet për pozicionet e shpallura vlerësohen nga një komision vlerësimi, i përbërë nga përfaqësues të fakultetit dhe departamentit. Në bazë të një vendimi të Senatit të vitit 2017-2018, procedurat e rekrutimit mund të zhvillohen edhe gjatë semestrit të dytë. <i>Evidenca; 4.2 Procedure rekrutimi stafi akademik</i> <i>Evidenca; 4.3 CV stafi akademik dhe personeli ndihmës akademik i angazhuar në programin e studimit</i> <i>Evidenca; 4.4 Vendim Senati për procedurat e rekrutimit</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Departamentit i Shkencave Ekonomike, që mbulon këtë program studimi, përfshin në strukturën e tij edhe staf ndihmës akademik të angazhuar për të siguruar funksionimin e rregullt të procesit mësimor. Përveç kësaj, në laboratorët dhe mjediset e tjera të vëna në dispozicion të studentëve, është i pranishëm personel ndihmës akademik që luan një rol thelbësor në mbështetjen e zhvillimit efikas të procesit mësimor, bazuar në kërkesat dhe nevojat e tij. Ky fakt u konfirmua edhe nga GVJ gjatë vizitës në institucion. <i>Vizita në institucion nga GVJ.</i> <i>Evidenca: Tabelat përmbledhëse aneks RVB 6.1; 6.2; 6.3; 6.4; 6.5.</i> <i>Evidenca: 2.4.a,b,c,d,e Ngarkesa e personelit akademik</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit	Nga analiza e dokumentacionit të dorëzuar për aplikim dhe verifikimi i kryer nga GVJ pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, rezulton se është vendosur një praktikë e rregullt për përditësimin e të dhënave të personelit akademik të angazhuar në këtë program. Dosjet e shqyrtuara në mënyrë rastësore nga GVJ tregojnë se informacioni mbi stafin akademik dhe ndihmës përditësohet çdo vit dhe organizohet në dosje personale standardizuara, në përputhje me rregulloren përkatëse.

përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	<i>Vizita në institucion nga GVJ.</i> <i>Evidenca; 4.1.a,b Kontrata PAE , Kontrata PAK</i>			
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	AU ka nënshkruar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me kompani dhe përfaqësues të biznesit, të cilat lehtësojnë zhvillimin e praktikës profesionale për studentët. Staf i akademik i angazhuar në këtë program luan një rol aktiv në monitorimin dhe mbikëqyrjen e procesit të praktikës profesionale pranë këtyre institucioneve. Implementimi i praktikës, si një element kyç i programit të studimit, realizohet në bazë të udhëzuesit të hartuar nga institucioni. Gjatë vizitës në institucion, GVJ vërejtë se përgjegjësi i DSHE cakton një përgjigjës për mbikëqyrjen e procesit të praktikës profesionale. Në programin e studimit "Financë-Bankë", temat e diplomave mbrohen përmes punimit të tezës, sipas afateve të përcaktuara në kalendarin akademik. Përgjegjësi i DSHE u komunikon studentëve fondin e temave të diplomave, ndërsa studentët zgjedhin pedagogët mbikëqyrës bazuar në fushat e tyre të ekspertizës. Punimet më të spikatura janë prezantuar në konferenca, duke përfshirë Konferencën e AMF-së në vitin 2018 dhe një konferencë të përbashkët me Universitetin "Fan Noli" në vitin 2021. Disa prej punimeve janë botuar edhe në revistën Optime. <i>Evidenca; 3.7 Lista e temave të diplomës v.a 2022-2023</i> <i>Evidenca; 4.5 Botim i stafit në revistën optime</i> <i>Evidenca; 1.10 Marrëveshje bashkëpunimi</i>			
Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Gjatë takimeve me stafin e programit të ciklit të parë Bachelor në "Financë-Bankë" dhe studentët, u evidentua angazhimi i pedagogëve në monitorimin e procesit të praktikës profesionale dhe mbështetja që ata ofrojnë gjatë hartimit të raportit përfundimtar, të cilin studenti dorëzon pas përfundimit të praktikës. <i>Evidenca: 1.2 Rregullore e programit BSc.Financë-Bankë neni 29</i>			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni dhe vëzhgimet e kryera gjatë vizitës, GVJ konstaton se numri i stafit akademik të angazhuar në këtë program ka pasur mungesë qëndrueshmërie. Institucioni duhet të ndërmarrë masa për të motivuar stafin akademik, me qëllim sigurimin e stabilitetit dhe vazhdimësisë në përbërjen e tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

			X	
--	--	--	---	--

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit dhe vizitën në institucionin e AU, sidomos në njësinë kryesore të FSHAE dhe DSHE, GVJ vëren se institucioni disponon salla leksionesh dhe auditorë seminarësh që plotësojnë kërkesat për realizimin e suksesshëm të programit. Përveç kësaj, janë siguruar ambiente mbështetëse dhe hapësira të përshtatshme për stafin akademik dhe ndihmës, të cilat shërbejnë në funksion të nevojave të studentëve. Këto ambiente ndodhen në një godinë të pajisur me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim të rregullt të aktiviteteve të institucionit. <i>Evidenca :4.6 Planimetritë e godines</i> <i>Vizita në institucion nga GVJ</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitave në institucion, u konstatua se ambientet janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për realizimin e programit "Bachelor" në "Financë-Bankë". Këto përfshijnë salla leksionesh, zyra dhe laboratore, të cilat plotësojnë kriteret teknike dhe normativën e sipërfaqes së përdorshme, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017. Institucioni ofron një tregues prej 4.575 m ² për student, tej normës së kërkuar prej 2.5 m ² . Godina është e pajisur me Office 365 dhe mbulim të plotë Wi-Fi. <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i> <i>Evidenca :4.6 Planimetritë e godines</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Institucioni disponon laboratorë informatike të pajisur me programe moderne, të cilët mbështesin procesin mësimor dhe aktivitetet shkencore. Këto laboratorë janë në dispozicion të studentëve dhe stafit, duke shërbyer për zhvillimin e seminareve, realizimin e detyrave të kursit dhe përgatitjen e temave të diplomës. <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i> <i>Evidenca :4.6 Planimetritë e godines</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një	Laboratori është i pajisur me 24 kompjuterë, të cilët përdoren për lëndët e programit "Financë-Bankë". Përveç aplikacioneve bazë, në këta

laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	kompjuterë janë instaluar programe moderne, duke përfshirë edhe "Financa 5". Laboratorët janë të disponueshëm për studentët si gjatë orëve të mësimit, ashtu edhe për përgatitjen e detyrave të kursit.			
Konkluzione	<i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i> <i>Bazuar në dokumentacionin e siguruar dhe vizitën e kryer, GVJ vlerëson se mjediset mësimore dhe infrastruktura që mbështesin programin janë të përshtatshme për funksionimin normal të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit dhe vizitën e GVJ në bibliotekën e AU, konstatohet se studentëve u vihet në dispozicion literaturë bazë dhe ndihmëse, e përcaktuar në syllabuset përkatëse, si në format fizik ashtu edhe digjital. Gjithsesi, sugjerohet shtimi i titujve në shqip dhe gjuhë të huaj, veçanërisht i botimeve të viteve të fundit, për të pasuruar më tej fondin e bibliotekës dhe për të mbështetur më mirë programin. <i>Evidenca : 4.7 Titujt e librave në bibliotekë.</i> <i>Vizita në institucion nga GVJ</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit dhe vizitën e GVJ në bibliotekë, u konstatua se për disa lëndë të programit literatura bazë është e vjetëruar. Gjatë vizitës në AU, u evidentua se institucioni ka bërë kërkesë për pasurimin e fondit të bibliotekës me tekste bashkëkohore të përshtatshme për këtë program. <i>Evidenca : 4.8 Procedure e pasurimit të bibliotekës.</i> <i>Vizita në institucion nga GVJ</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin dhe vizitën në FSHAE të AU, u konstatua se studentët e programit kanë akses në Bibliotekën Mësimore, e cila ndodhet në të njëjtën godinë ku zhvillohet mësimi. Kjo bibliotekë u ofron studentëve mundësi të barabarta për të përdorur shërbimet, për të studiuar dhe për të aksesuar literaturën e disponueshme. Orari i shërbimit është përshtatur për të përmbushur nevojat e tyre, me hapje nga e hëna deri të premten, ora 08:30-16:00, dhe të shtunën, ora 08:00-12:00. Megjithatë, sugjerohet zgjerimi i hapësirave për studim për të përmbushur më mirë kërkesat e studentëve.

	<i>Evidenca : 4.7 Titujt e librave në bibliotekë.</i> <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion, u konstatua se biblioteka është relativisht e pajisur me literaturë fizike në shqip, duke përfshirë tekste mësimore, libra, revista periodike dhe buletine institucionale që mbështesin programin “Bachelor” në “Financë-Bankë”. Shërbimi i bibliotekës ofrohet nga staf i dedikuar. Megjithatë, theksohet nevoja për pasurimin e mëtejshëm të fondit me literaturë bashkëkohore. <i>Evidenca : 4.7 Titujt e librave në bibliotekë.</i> <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Biblioteka ofron akses të barabartë për të gjithë përdoruesit, përfshirë studentët dhe stafin akademik, përmes anëtarësimit. Për programin "Financë-Bankë", biblioteka siguron gjithashtu qasje në burime online multidisiplinare si EBSCO, ERIC (Education Resources Information Center) dhe Cambridge Journals. www.cambridge.org/core. https://z-lib.org/. <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka disponon një program kompjuterik që ndihmon studentët në aksesimin e librave online. Megjithatë, u vërejt se në bibliotekë janë vetëm dy kompjuterë në dispozicion të studentëve. <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është e hapur nga e hëna deri të premten, nga ora 08:00 deri në 16:00, dhe të shtunën nga 08:00 deri në 12:00, duke ofruar shërbime për studentët e të gjitha programeve. Këto orare janë të shpallura në mjediset e AU. Çdo student ka një kartelë regjistrimi, përmes së cilës mund të aksesojë literaturën. Salla e bibliotekës disponon kënde leximi dhe disa tavolina për studim. <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në	GVJ, duke u mbështetur në dokumentacionin e aplikimit për akreditim dhe vizitën në AU, vëren se ka pasur një komunikim institucional lidhur me pasurimin e fondit të bibliotekës. Në lidhje me mungesat e evidentuara në literaturën bashkëkohore të programit, dekani i FSHAE ka bërë një kërkesë më 01/03/2022 për të pasuruar fondin me disa tituj librash.

shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	<i>Evidenca : 4.8 Procedure e pasurimit të bibliotekë</i> <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni dhe vizitën e realizuar, GVJ arrin në përfundimin se institucioni disponon ambiente të dedikuara për studim dhe një bibliotekë me një fond relativisht të pasur literaturë që mbështet procesin e mësimdhënies për stafin dhe studentët. Sipas syllabuseve të lëndëve të programit, është e nevojshme që institucioni të pasurojë më tej fondin e bibliotekës me literaturë më të re, përfshirë materiale në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Administrimi i informacionit lidhur me studentët dhe aktivitetet e tyre realizohet nga njësitë kryesore të UL, përmes sekretarisë mësimore. Për menaxhimin e të dhënave të studentëve, institucioni përdor sistemin "Pitagora", i ofruar nga RASH. Gjatë vizitës, GVJ zhvilloi takime dhe monitorime pranë sekretarisë mësimore të FSHAE, ku vërejti administrimin e informacionit për studentët, nga faza e regjistrimit deri në procesin e diplomimit. <i>Evidenca : 3.8 Manual i përdorimit të Pitagorës</i> <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit	Të gjitha informacionet që lidhen me personelin akademik dhe ndihmës akademik ruhen në njësitë përkatëse, si burimet njerëzore, zyra e koordinimit të mbështetjes për studentët, zyra e marrëdhënieve me jashtë, zyra e koordinimit të kërkimit shkencor dhe botimeve akademike.



akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi online përditësohet me të gjithë informacionin që mbulon procesin e regjistrimit, zhvillimin e programit dhe diplomimin e studentëve, duke mundësuar bashkërendimin e informacionit ndërmjet pedagogëve dhe studentëve. <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i> <i>Evidenca :3.8 Manual i përdorimit të Pitagorës</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	AU siguron informacionin e nevojshëm jo vetëm përmes platformës "Pitagora" për studentët, por edhe përmes kanaleve të tjera elektronike. Po ashtu, e-maili mbetet një nga format kryesore të komunikimit. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit, i cili përfshin të gjitha platformat dhe mjetet e përmendura, mundëson monitorimin dhe shpërndarjen e informacionit në kohë reale mbi veprimtaritë administrative dhe akademike të institucionit.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	<i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i> <i>Evidenca :3.8 Manual i përdorimit të Pitagorës</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Sipas konstatimeve të GVJ-së, faqja e internetit e AU është në shqip dhe anglisht dhe ofron informacion mbi programet e studimit, stafin, si dhe njoftime për datat e provimeve, oraret e studimeve dhe mundësitë e punësimit. Institucioni përditëson rregullisht faqen e tij të internetit dhe platformat e rrjeteve sociale për të siguruar një komunikim të vazhdueshëm me publikun. https://albanianuniversity.edu.al/sq/ https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/fakultetet/fakulteti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-ekonomike/ https://albanianuniversity.edu.al/sq/departamenti-i-shkencave-ekonomike/
Konkluzione	<i>GVJ, duke u bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni dhe në vizitën e realizuar në ambientet e tij, konstaton se sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit për administrimin dhe monitorimin e veprimtarisë akademike përmbush standardet e nevojshme për mbështetje të procesit mësimor, stafit akademik dhe studentëve të programit.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në dokumentet e paraqitura nga institucioni përfshihen Pasqyrat Financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2023, Raporti i Auditit të Pavarur dhe Projekt-Buxheti Fiskal. Sipas këtyre dokumenteve, të ardhurat e veprimtarisë janë rritur në krahasim me vitin 2022. Nga analiza e dokumentacionit, rezulton se institucioni ka qëndrueshmëri financiare, duke përfunduar me fitim dhe duke garantuar mbarëvajtjen e zhvillimit të programit nga këndvështrimi financiar. <i>Evidenca shtese: Pasqyrat financiare</i> <i>Evidenca shtese: Projektbuxheti-Viti Fiskal 2021.</i> <i>Evidenca shtese: Raporti auditit.</i> <i>Evidenca shtese: Raporti financiar</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Institucioni harton dokumentacionin bazë të përmendur më sipër të cilin e miraton në Bordin e Administrimit. Si një e tërë, dokumentacioni financiar evidenton qëndrueshmërinë financiare në mbarëvajtjen e programeve të studimit. Ky dokumentacion nuk hartohet në nivelin e njësisë bazë (departamentit) që mbulon këtë program. Të dhënat lidhur me tarifat, kostot për student, të ardhurat, etj., janë të përgatitura nga institucioni për të gjithë studentët e AU. <i>Mendojmë se, në kushte kur ka prirje të ulët numri i studentëve, institucioni duhet të hartojë dokumentacionin financiar edhe në nivelin e njësisë bazë, e cila do të saktësojë më mirë qëndrueshmërinë financiare të programit.</i> <i>Evidenca shtese: Pasqyrat financiare</i> <i>Evidenca shtese: Projektbuxheti-Viti Fiskal 2021.</i> <i>Evidenca shtese: Raporti auditit.</i> <i>Evidenca shtese: Raporti financiar</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e	"UFO" shpk, me aktivitet kryesor në fushën e arsimit, realizon auditim të brendshëm nga auditues të pavarur. Nga ana tjetër, në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni përfshihet edhe Raporti i

financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Auditorit të Pavarur për "UFO" shpk, si pjesë e detyrimeve procedurale. <i>Evidenca shtese :Raporti auditit.</i>			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	GVJ nuk evidentoi raportim të realizimit të buxhetit në njësinë bazë lidhur me aspekte financiare për programin e studimit.			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Bazuar në dokumentacionin financiar të AU, shikojmë se institucioni ka reflektuar qëndrueshmëri financiare gjatë tre viteve të fundit, si në rritjen e burimeve të të ardhurave ashtu edhe në rezultatin financiar. Nga ana tjetër, vazhdimi i prirjes në ulje të numrit të studentëve në të ardhmen mund të përbëjë një rrezik për qëndrueshmërinë financiare të vetë programit. Institucioni ka dëshmuar ndër vite se të ardhurat e tij janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet dhe për të gjeneruar fitime. <i>Evidenca shtese: Pasqyrat financiare</i> <i>Evidenca shtese :Projektbuxheti-Viti Fiskal 2021</i> <i>Evidenca shtese: Raporti financiar</i>			
Konkluzione	GVJ, bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni dhe vizitën e realizuar në institucion, konkludon se institucioni demonstroi qëndrueshmëri financiare, duke garantuar financimin dhe mbështetjen financiare për realizimin e procesit mësimor dhe kërkimor dhe, si rrjedhojë, mbarëvajtjen e këtij programi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka përcaktuar politika dhe procedura të qarta për procesin e regjistrimit të studentëve, realizimin e programeve të studimit dhe diplomimin e tyre. Për këtë qëllim, janë miratuar Statut AU, Rregullore AU, rregullore të FSHAE si dhe disa akte rregullative. Këto akte nënligjore dhe rregullative përmbajnë në mënyrë të detajuar të gjitha procedurat që përcjellin ecurinë e studentit nga regjistrimi deri në përfundim të programit. <i>Evidenca: 1.3.b Statut i miratuar nga MAS 2023</i> <i>Evidenca: 1.4.b Rregullore AU perditesuar</i> <i>Evidenca: 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike</i> <i>Evidenca: 1.7 Rreg. Dep. Shkencave Ekonomike</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ, pas vizitës në institucion, shqyrtimit të dokumentacionit dhe intervistave me studentët e programit, konstaton se politikat dhe procedurat e zbatuara gjatë gjithë ciklit të studimeve garantojnë barazinë dhe të drejtat e studentëve. Të gjitha procedurat mbështesin studentët në çdo fazë të përparimit të tyre gjatë programit të ciklit të parë të studimeve në "Financë-Bankë". <i>Evidenca: 1.4.b Rregullore AU perditesuar</i> <i>Evidenca: 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike</i> <i>Evidenca: 1.7 Rreg. Dep. Shkencave Ekonomike</i> <i>Evidenca : 1.2 Rregullore e programit BSc.Financë-Bankë.</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Në përputhje me kuadrin rregullator të përmendur më sipër, GVJ konstaton se kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen e kandidatëve fitues për regjistrim në këtë program janë përcaktuar qartë. Institucioni përcakton kriteret e pranimit dhe kuotat në përputhje me kapacitetet pritëse të AU. Sipas akteve rregullative, DSHE e cila mbulon këtë program, propozon kriteret e pranimit, të cilat miratohen nga Dekani dhe më pas nga Senati Akademik. Gjatë periudhës së përcaktuar nga MAS, AU organizon takime informuese me maturantët përmes grupeve të pedagogëve dhe stafit administrativ. <i>Evidenca: 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike</i> <i>Evidenca: 5.1 Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin</i> <i>Evidenca: e studimit</i> <i>Evidenca: 5.2 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit</i> <i>Evidenca: 5.3 Panairi "Work&Study"</i> <i>Evidenca: 5.4 Udhëzues Orientues për Maturantët.</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë	Procedura e pranimit për studentët e ciklit të parë në programin "Financë-Bankë" është e qartë dhe transparente. Studentët janë të detyruar të njohin këto kriteret, të cilat janë të thjeshta, të kuptueshme

kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	dhe të lehta për t'u ndjekur nga çdo person i interesuar. Po ashtu, kriteret dhe procedurat e regjistrimit dhe transferimit janë të qarta dhe të kuptueshme. Të gjitha këto informacione janë bërë publike dhe janë të aksesueshme në faqen e internetit të universitetit. <i>Evidenca: 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</i> <i>Evidenca: 1.7 Rreg. Dep. Shkencave Ekonomike</i> <i>Evidenca : 1.2 Rregullore e programit BSc.Financë-Bankë.</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Universiteti dhe fakulteti kanë politika të përgjithshme për rekrutimin, si dhe politika specifike për pranimin e studentëve në çdo program studimi. Informimi i maturantëve fillon në datat e përcaktuara nga MAS, dhe kandidatët e interesuar informohen në mënyrë të vazhdueshme për përmbajtjen e programeve. <i>Evidenca: 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</i> <i>Evidenca: 5.3 Panairi "Work&Study"</i> <i>Evidenca: 5.4 Udhëzues Orientues për Maturantët.</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni përgatit dhe publikon, para fillimit të vitit akademik, kriteret specifike për kandidatët me aftësi të veçanta ose për ata nga grupe të pakicave. <i>Evidenca 1. Kuotat</i> <i>Evidenca 2. Bursat</i> <i>Evidenca: 5.1 Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në kuadrin rregullativ të AU-së, të përmendur më sipër edhe më sipër, nenet dhe kriteret e pranimit përcaktojnë gjithashtu kriteret specifike për kandidatët nga vende të tjera. <i>Evidenca: 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</i> <i>Evidenca: 1.7 Rreg. Dep. Shkencave Ekonomike</i> <i>Evidenca : 1.2 Rregullore e programit BSc.Financë-Bankë.</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Gjatë vizitës së GVJ në institucion, si dhe në shqyrtimin e dokumentacionit mbështetës, u evidentuan raste mbështetjeje financiare për studentët e ciklit të parë Bachelor në rang universiteti. <i>Evidenca 1. Kuotat</i> <i>Evidenca 2. Bursat</i> <i>Evidenca: 5.1 Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit</i>
Konkluzione	GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga institucioni dhe vizitës në AU, konstaton se institucioni ka procedura të plota për pranimin, regjistrimin dhe transferimin e studentëve gjatë gjithë

	<i>periudhës së studimeve si dhe miraton kuotat dhe bursat për rastet e kandidatëve me aftësi të vecanta.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit pranë ASCAL-it të AU, si dhe në takimet me studentët dhe stafin akademik gjatë vizitës në institucion, u konstatua se studentët e regjistruar në këtë program kanë akses të plotë në informacion mbi ecurinë dhe progresin e tyre akademik. Kjo realizohet përmes njohjes së programit të studimit, rregullores dhe procedurave të pranimit. Informacioni i përgjithshëm i sigurohet studentëve përmes faqes zyrtare të internetit të AU, ku përditësohen njoftime dhe informacione të rëndësishme si orari mësimor, grafiku i provimeve dhe datat e eventeve të tjera. Informacioni specifik për modulet e programit u prezantohet studentëve në fillim të çdo lënde përmes syllabuseve dhe literaturës së përcaktuar. <i>Evidenca: 1.2 Rregullore e programit BSc.Financë-Bankë</i> <i>Evidenca: 2.2 Syllabuse viti I;II;III</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Zyra e Transferimeve dhe Ekuivalentimeve, në bashkëpunim me Departamentin, informon studentët mbi kriteret për njohjen e studimeve të mëparshme, duke përfshirë llojin e shkollave dhe nivelin e plotë ose të pjesshëm të studimeve. AU lejon transferime nga programe, fakultete ose universitete të tjera, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, me kusht që të plotësohen kreditet e përcaktuara sipas ligjit për arsimin e lartë, rregullores së institucionit dhe statutit të universitetit. <i>Evidenca 5.5 Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve - VS 25 - dt. 25.06.2020</i> <i>Evidenca: 1.2 Rregullore e programit BSc.Financë-Bankë</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Financë-Bankë përfshin një pjesë të rëndësishme që trajton vlerësimin e njohurive dhe format e vlerësimit. Procedurat janë të përcaktuara qartë, duke përfshirë llojet e provimeve, provimet e pjesshme dhe finale për secilën lëndë, si dhe mënyrat e organizimit të tyre. Format i vlerësimit dhe afatet për përmbushjen e detyrimeve shpjegohen gjatë javës së parë të vitit akademik, në kuadër të ditëve orientuese të organizuara nga Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve (ZKMS). Gjithashtu,

	format e vlerësimit dhe afatet për çdo lëndë prezantohen në orët e para të kontaktit ndërmjet pedagogëve dhe studentëve në auditor, duke qenë të përcaktuara edhe në syllabusat përkatëse. <i>Evidenca: 1.2 Rregullore e programit BSc.Financë-Bankë</i> <i>Evidenca: 2.2 Syllabuse viti I;II;III</i> <i>Evidenca : 5.9 Rregullore e Zyres se Koordinimit dhe Mbeshtetjes ndaj Studenteve.</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Nga takimi me studentët dhe shqyrtimi i rregullores së programit, GVJ konstatoi se, brenda muajit të parë të vitit akademik, studentët që diplomohen njoftohen mbi programin e temave të diplomave. Procesi i diplomimit realizohet përmes mbrojtjes së një teze diplome ose të një provimi formimi. Studentet me mesataren e tre viteve akademike < 7,5 kryejnë provimim formimi. <i>Evidenca: 1.2 Rregullore e programit BSc.Financë-Bankë Kreu V, neni 30</i> <i>Evidenca : 3.7 Lista e temave të diplomës v.a 2022-2023</i> <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Universiteti dhe Fakulteti zbatojnë politika të përgjithshme për rekrutimin dhe politika specifike për pranimin e studentëve në çdo program studimi. Informimi i maturantëve nis në datat e përcaktuara nga MAS dhe vazhdon me njoftime të rregullta, duke u ofruar kandidatëve të interesuar informacion të detajuar mbi përmbajtjen e programeve. <i>Evidenca: 5.3 Panairi "Work&Study"</i> <i>Evidenca: 5.4 Udhëzues Orientues për Maturantët.</i>			
Konkluzione	GVJ vëren se AU disponon dokumentacion të plotë për të informuar studentët lidhur me kriteret e pranimit, detyrimet për programin e studimit, rregullat dhe afatet për përmbushjen e tyre, procesin e diplomimit, si dhe kriteret për pranimin dhe transferimin e studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën,	Institucioni ofron informacion të detajuar për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit, si para ashtu edhe gjatë periudhës së regjistrimeve. Java e orientimit dhe mirëseardhjes, takimet informuese

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-13423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	dhe vizitat gjatë regjistrimeve ndihmojnë studentët e rinj të marrin vendime të informuara për regjistrimin. Dokumentacioni dhe kontaktet me studentët konfirmojnë që ata janë të mirëinformuar mbi programin dhe mundësitë e tij. <i>Evidenca: 5.4 Udhëzues Orientues për Maturantët.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në Rregulloren e programit të ciklit të parë Bachelor në Financë-Bankë përfshihet programi mësimor, i organizuar sipas lëndëve/moduleve, me ndarjen e ngarkesës mësimore brenda dhe jashtë auditorit. Studentët informohen për përmbajtjen e programit për secilën lëndë që në fillim të procesit mësimor. <i>Evidenca: 1.2 Rregullore e programit BSc.Financë-Bankë</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Studentët e AU janë të mirëinformuar për mundësitë e punësimit që nga fillimi i studimeve e gjatë gjithë periudhës akademike. Gjatë takimeve me ta, u evidentua ndërgjegjësimi për marrëdhëniet e bashkëpunimit të institucionit me aktorë të ndryshëm të biznesit në vend. Në këtë drejtim, një rol të rëndësishëm luajnë Zyra e Këshillimit për Mundësitë e Studimit (ZKMS) dhe Zyra e Karrierës dhe Alumni (ZKA). Këto zyra ofrojnë informacion të vlefshëm dhe asistencë konkrete për studentët, duke i ndihmuar ata të orientohen drejt mundësive të punësimit dhe zhvillimit profesional në të ardhmen. <i>Evidenca : 5.6 Leksion i hapur "Si të punësohesh"</i> <i>Evidenca 5.7 Leksion i hapur për nxitjen e studentëve për punësim</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët kanë akses të plotë në informacion, si përmes kanaleve të komunikimit elektronik të përmendura më lart, ashtu edhe përmes kontakteve direkte me stafin akademik të programit, drejtuesit e njësive kryesore, ZKMS dhe ZKA. <i>Evidenca : 5.8 Axxhenda e javës orientuese</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Sistemi i informacionit, në të gjitha format e përmendura më lart, është i aksesueshëm edhe për studentët që ndjekin mësim në distancë. Gjatë takimeve me studentët e programit, ata shprehën një vlerësim pozitiv për lehtësinë e marrjes së informacionit. <i>Takimi me studentët e programit realizuar gjatë vizitës së GVJ në institucion</i>
Konkluzione	AU ofron mënyra dhe metoda të ndryshme për informimin e studentëve mbi organizimin dhe funksionimin e programit të studimeve. Studentët e këtij programi kanë akses në informacion përmes kanaleve elektronike dhe janë të integruar në një platformë të veçantë për informim të brendshëm.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve				
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	Të diplomuar (2019-2020)	Të diplomuar (2020-2021)	Të diplomuar (2022-2023)	Të diplomuar (2023-2024)	Total
	35	46	36	38	155
	AU ofron të dhëna dhe statistika të përditësuara çdo vit, të cilat përfshijnë informacion mbi numrin e studentëve të diplomuar për çdo vit akademik në këtë program studimi. Sipas raportit vjetor, nga viti 2019 deri në vitin 2024, numri total i studentëve të diplomuar është: <i>Evidenca: Tabela përmbledhëse aneks RVB tabela 21</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i>				
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Të rregjistruar (2019-2020)	Të rregjistruar (2020-2021)	Të rregjistruar (2021-2022)	Të rregjistruar (2022-2023)	Të rregjistruar (2023-2024)
	42	58	27	32	34
	AU ofron të dhëna dhe statistika të përditësuara çdo vit, të cilat përfshijnë informacion mbi numrin e studentëve të diplomuar për çdo vit akademik në këtë program studimi. Sipas raportit vjetor, nga viti 2019 deri në vitin 2024, numri total i studentëve të regjistruar dhe transferuar nga viti I viti i II dhe viti i III për total të viteve është: Sipas të dhënave statistikore dhe inspektimeve nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) gjatë periudhës 2019-2024, vërehet një rënie në total të numrin të përgjithshëm të studentëve të regjistruar në program. <i>Evidenca: Tabela përmbledhëse aneks RVB tabela 21</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i>				
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të universitetit, i cili përfshin regjistra të printuar dhe dokumente elektronike. Këto të dhëna janë të lehta për t'u kontrolluar dhe verifikuar nga ekspertët e vlerësimit të jashtëm. Gjatë vizitës në				

brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	sekretarinë mësimore, GVJ ka verifikuar regjistrimet e studentëve në regjistrin themeltar. Institucioni përdor sistemin Pitagora dhe të dhënat mblidhen nga dokumentet bazë, procesverbalet dhe dokumentet e tjera të përgatitura dhe plotësuara në përputhje me aktet dhe rregulloret e AU. <i>Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Evidenca : 3.13 Rregullore e sekretarise mesimore.</i>			
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara nga sekretaria mësimore i nënshtrohen kontrolleve periodike nga strukturat e tjera mbikëqyrëse, si rektorati dhe Zyra e Kontrollit dhe Auditit të Brendshëm. Sipas rregullores së sekretarisë, kryesekretari i fakultetit paraqet një raport të detajuar për dekani dhe rektorin mbi realizimin e detyrave. <i>Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Evidenca: 1.3.b Statut i miratuar nga MAS 2023</i> <i>Evidenca: 1.4.b Rregullore AU perditesuar</i> <i>Evidenca : 3.13 Rregullore e sekretarise mesimore</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Gjatë vizitës së realizuar nga GVJ në institucion, u vu re bashkëpunimi ndërmjet Departamentit të Shkencave Ekonomike (DSHE) dhe Zyrës së Kontrollit dhe Auditimit (ZKA) të universitetit për shkëmbimin dhe analizën e të dhënave të studentëve të regjistruar. Në raportet e përgatitura nga departamenti përfshiheshin të dhëna mbi hyrjen dhe daljen e numrit të studentëve. Gjithashtu ZKA përpilon raporte analitike mbi punësimin e studentëve ku u vu re se përqindja më e madhe e të punësuarve përsa i përket FSHAE ishte në përputhje me programin e studimit. <i>Evidenca: Tabela përmbledhëse aneks RVB tabela 21</i> <i>Evidenca : 5.14 Statistika të punësimit të studentëve</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i>			
Konkluzione	GVJ konkludon se institucioni i plotëson plotësisht kriteret përsa i përket evidentimit, përditësimit dhe ruajtjes së të dhënave lidhur me procesin e mësimdhënies, nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në përputhje me ligjin 80/2015, statutin dhe rregulloret e tij, AU garanton përfaqësimin e studentëve në proceset vendimmarrëse dhe këshilluese në nivel institucional, si në Senatin Akademik, Këshillin Studentor, dhe Komisionin për Kurrikulat dhe Mësimdhënien. Sipas rregullores së AU, operon gjithashtu Këshilli Studentor, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e studentëve. U evidentua pjesëmarrja e studentëve në këto organe vendimmarrëse, si dhe angazhimi i tyre në takimet e zhvilluara nga këto struktura, përmes vendimeve të miratuara për ngritjen dhe funksionimin e tyre. <i>Evidenca; 1.3.b Statut i miratuar nga MAS 2023</i> <i>Evidenca; 1.4.b Rregullore AU perditesuar</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Nga shqyrtimi i dosjes së aplikimit të institucionit pranë ASCAL-it dhe takimit me studentët gjatë vizitës së GVJ në institucion, u theksua roli aktiv i studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse. Studentët gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në vlerësimin periodik të nivelit të mësimdhënies, proces i cili realizohet përmes anketave anonime dhe diskutimeve direkte me titullarët e lëndëve përkatëse. Për më tepër, në RVB të programit, një nga anëtarët e grupit është student. Pjesëmarrja e studentëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit bëhet kryesisht përmes vlerësimeve të tyre, të cilat përforcohen nga diskutimet që studentët zhvillojnë me pedagogët e lëndëve. <i>Evidenca; 1.3.b Statut i miratuar nga MAS 2023</i> <i>Evidenca 6.9.f Rezultatet e pyetësorit drejtuar studentëve</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezulttit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Bazuar në kuadrin rregullator të institucionit dhe takimin e GVJ me studentët e programit, u vërejt se studentët kanë mundësinë të shprehin mendimet e tyre për përmirësimin e programit dhe kanë të drejtën e ankimimit në lidhje me procesin e vlerësimit. Po ashtu, nga takimi me stafin akademik që ofron këtë program, u konfirmua se studentët mund të shprehin ankesat e tyre dhe janë të angazhuar në gjetjen e zgjidhjeve. <i>Evidenca : 1.2 Rregullore e programit BSc.Financë-Bankë</i> <i>Evidenca 6.9.f Rezultatet e pyetësorit drejtuar studentëve</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i>



Konkluzione	Studentët janë pjesë e strukturave drejtuese të universitetit, dhe prania e tyre në këto struktura është e garantuar nga institucioni. Megjithatë, ata shpesh nuk shprehin shqetësime apo sugjerime për përmirësimin e programeve. Studentëve u ofrohen mundësitë e nevojshme për të rishikuar vlerësimet e tyre nëse konsiderojnë se rezultatet e arritura nuk përputhen me pritshmëritë e tyre. Pedagogët janë të gatshëm dhe të detyruar të ofrojnë sqarime përmes seancave të posaçme kur është e nevojshme.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	AU ofron informim dhe mbështetje për studentët kryesisht përmes zyrave të dedikuara për pritjen, informimin dhe këshillimin e tyre, siç janë Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve (ZKMS) dhe Zyra e Karrierës dhe Alumni (ZKA). Nga takimet e GVJ-së me anëtarët e këtyre zyrave dhe studentët, u konstatua se këto zyra funksionojnë në shërbim të studentëve, në përputhje me aktet rregullatore të AU-së. <i>Evidenca : 5.9 Rregullore e Zyres se Koordinimit dhe Mbeshtetjes ndaj Studenteve</i> <i>Evidenca: 5.10 Rregullore e Zyres se Karrieres dhe Alumnit</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Informimi i studentëve për programin e studimit realizohet nga procesi i regjistrimit, gjatë zhvillimit të programit dhe deri në përfundimin e diplomimit, kryesisht përmes Sekretarisë Mësimore, ZKMS dhe ZKA. Studentët mund të marrin informacion mbi ecurinë e vlerësimit të procesit mësimor edhe nga anëtarët e stafit akademik që mbulojnë këtë program dhe nga njësia bazë e institucionit. Në fillim të çdo viti akademik, FSHAE, si njësi kryesore e programit, organizon javën e orientimit për studentët, ku ata marrin informacion të detajuar mbi procesin mësimor, platformat e përdorura, mënyrat e vlerësimit, modelin e programit të lëndëve, etj. <i>Evidenca : 5.9 Rregullore e Zyres se Koordinimit dhe Mbeshtetjes ndaj Studenteve</i> <i>Evidenca: 5.10 Rregullore e Zyres se Karrieres dhe Alumnit</i> <i>Evidenca: 5.11 Manuali i Studentit</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i>

Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	ZKA ndjek të gjithë procesin e informimit për studentët dhe bashkëpunon me struktura të tjera të institucionit për të siguruar një informim të plotë dhe të saktë. Këto zyra mbajnë gjithashtu lidhje me tregun e punës, duke orientuar studentët për mundësi praktike dhe mundësi punësimi. <i>Evidenca: 5.10 Rregullore e Zyres se Karrieres dhe Alumnit</i> <i>Evidenca:5.13 Aktivitete ekstrakurrikulare.</i> <i>Takime me përfaqësues të ZKA gjatë vizitës në institucion të GVJ</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	ZKA monitoron vazhdimisht punësimin e studentëve gjatë periudhës së studimeve dhe pas diplomimit. Çdo vit akademik, kjo zyrë përgatit një raport analitik, duke përditësuar të dhënat mbi punësimin e studentëve për çdo nivel programi. <i>Evidenca: 5.10 Rregullore e Zyres se Karrieres dhe Alumnit</i> <i>Takime me përfaqësues të ZKA gjatë vizitës në institucion të GVJ</i> <i>Evidenca : 5.14 Statistika të punësimit të studentëve</i>			
Konkluzione	AU ka zyra të dedikuara që ndjekin progresin dhe ecurinë e programit të studimit Bachelor në "Financë-Bankë". Sekretaria Mësimore, ZKA dhe ZKMS janë kanalet kryesore për informimin e studentëve, si para, gjatë, ashtu edhe pas diplomimit. Nga perspektiva institucionale, këto zyra monitorojnë progresin akademik dhe zhvillimin e karrierës së studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në vizitën në AU, grupi i ekspertëve të jashtëm evidentoi manualin e përdorimit të platformës TEAMS i cili trajton zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, të përshtatura sipas fushës së studimeve apo lëndëve/moduleve. <i>Evidenca nr 3.4 Manuali i Përdorimit të Platformës TEAMS.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Për programin e studimeve bachelor në “Financë-Bankë” pranë AU, janë krijuar struktura të posaçme që merren me ndjekjen, monitorimin dhe vlerësimin periodik të aftësive dhe cilësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Këto struktura përfshijnë Zyrën e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), Zyrën e Këshillimit dhe Kurrikulave, si dhe Komisionin për Kurrikulat dhe Mësimdhënien, të cilët bashkëpunojnë me njësinë bazë të programit. Në mënyrë periodike, këto njësi kryejnë vlerësimin e mësimdhënies për të garantuar standardet dhe cilësinë e kërkuar. <i>Evidenca: 6.6 Rregullore për mbarevajtjen e kurrikulave dhe procesit mesimor ne AU</i> <i>Evidenca: 6.11 Rregullore NJSBC</i> <i>Evidenca 3.5 Shembull raport semestral pedagogu</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	AU i jep rëndësi të veçantë mendimit dhe opinionit të studentëve në lidhje me vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies. Për këtë qëllim, institucioni organizon dy herë në vit pyetësorë vlerësimi për pedagogët. Përmes këtyre pyetësorëve, studentët japin vlerësimet e tyre mbi lëndët, procesin e mësimdhënies, metodat e përdorura, aplikimin dhe kombinimin e tyre, si dhe lidhjen me literaturën dhe elementët e tjerë përkatës. <i>Evidenca 6.9.d Rezultatet e pyetësorit drejtuar studentëve për mësimin online v.a. 2020 – 2021</i> <i>Evidenca 6.9.f Rezultatet e pyetësorit drejtuar studentëve v.a. 2021 – 2022</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur për aplikim, institucioni ka përcaktuar strukturën përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, duke përfshirë NJSBC-në në nivel institucional dhe pedagogët përgjegjës në nivel departamenti. Nga dokumentacioni, vërehet se ekziston pyetësor i detajuar në nivel programi, i cili përfshin procesin e vlerësimit të mësimdhënies për programin që po shqyrtojmë. <i>Evidenca: 6.11 Rregullore NJSBC</i> <i>Evidenca: 6.3.f Pedagogët përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë në nivel Departamenti – v.a. 2023 – 2024</i>



Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit të aplikimit, nuk u identifikuan mekanizma promovimi apo praktika të mira që do të inkurajonin personelin akademik për të përmirësuar punën e tyre në të ardhmen.			
Konkluzione	<i>Universiteti ka një strukturë të dedikuar, NJSBC, e cila mbikëqyr dhe garanton ecurinë e programeve të studimit, duke u fokusuar gjithashtu në përmirësimin e procesit të mësimdhënies. Përfshirja e studentëve në këtë proces është e garantuar. Megjithatë, GVJ evidentoi se nuk ka asnjë raport nga NJSBC lidhur me rezultatet e pyetësorëve dhe mungojnë analizat e të dhënave për programin e studimit Bachelor në Financë-Bankë. Gjithashtu, nuk u identifikua asnjë promovim i shembujve të mirë apo praktikave për përmirësimin e mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	AU ka zhvilluar dhe zbaton politika që synojnë monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, në përputhje me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë, aktet në fuqi dhe rregulloret institucionale. Në nivel universitar është krijuar struktura përgjegjëse, NJSBC, e cila funksionon bazuar në akte rregullative. Institucioni ka miratuar gjithashtu strategjinë e NJSBC, e cila përshkruan kornizën për këtë komponent. <i>Evidenca: 6.4 Strategjia për Sigurimin e Cilësisë 2022 - 2025.</i> <i>Evidenca: 6.11 Rregullore NJSBC</i> <i>Evidenca: 6.6 Rregullore për mbarevajtjen e kurrikulave dhe procesit mesimor në AU</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin	Në nivel institucional është krijuar struktura kryesore, NJSBC si dhe njësi të tjera mbështetëse. Po ashtu, DSHE, si njësi bazë, monitoron procesin e mësimdhënies, siguron respektimin e programeve të studimit, vijueshmërinë e mësimin, plotësimin e javëve mësimore dhe elementët e tjerë të parashikuar. Përveç kësaj, AU ka përfshirë edhe ekspertë të jashtëm në këtë proces.

e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<i>Evidenca: 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise 2022 - 2025.</i> <i>Evidenca: 6.5.a VB - E. Pano konsulente juridike prane NJSBC.</i> <i>Evidenca 6.5.b VB - B. Kola konsulent per zhvillimin e kurrikulave</i>			
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Ekzistojnë disa elemente që shërbejnë për vlerësimin e cilësisë, përfshirë formularë dhe pyetësorë të plotësuar anonimisht nga studentët, kontrollime paralele, kontrolle vertikale nga njësia bazë, organizimin e seancave të veçanta nga NJSBC, si dhe raportet e vlerësimit të pedagogëve nga studentët. <i>Evidenca: 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise 2022 - 2025.</i>			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit dhe vizita në institucion, GVJ vërejtë se institucioni realizon vlerësimin e pedagogut nga studentët përmes formularëve tip, si dhe vlerësimin e pedagogut nga eprorët në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Në procesin e monitorimit të mësimdhënies, GVJ evidentoi rezultatet, por NJSBC nuk kishte një raport më të detajuar, ku të përfshihen analiza më të thella të treguesve të nxjerrë nga përpunimi i formularëve dhe të shprehet një vlerësim i detajuar për secilin pedagog në aspekte të ndryshme, përfshirë mësimdhënien, projektet, punën kërkimore, punën administrative dhe angazhimet e tjera profesionale. Gjithashtu, nuk rezulton që AU të ketë identifikuar mangësi apo dobësi në procesin e sigurimit të cilësisë së mësimdhënies dhe realizimin e plotë të programit Bachelor në Financë-Bankë.			
Konkluzione	<i>Universiteti është i angazhuar për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së brendshme të mësimdhënies, duke pasur struktura të dedikuara që monitorojnë dhe realizojnë këtë proces, si dhe duke përdorur tregues të matshëm dhe të dukshëm. Megjithatë, nuk ka një raport me një analizë të plotë të rezultateve dhe nuk janë identifikuar mangësi apo dobësi në programin e studimit që po vlerësohet nga GVJ.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit dhe vizitën në institucion, GVJ evidentoi se institucioni përdor mekanizma formalë dhe i dokumenton ato lidhur me mbikëqyrjen periodike të programit të studimit. Kjo realizohet periodikisht dy herë në vit nëpërmjet realizimit të anketimeve me studentët e programit si dhe plotësimit të formularëve të performancës së pedagogëve nga eprorët. Megjithatë, siç kemi theksuar më lart, GVJ nuk evidentoi analiza të dobësive apo praktikave dhe arritje të mira për motivimin e stafit akademik. <i>Evidenca: 6.11 Rregullore NJSBC</i> <i>Evidenca: 6.3.f Pedagogët përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë në nivel Departamenti – v.a. 2023 - 2024</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Raporti i vlerësimit në nivel institucional i nënshtrohet analizës në strukturat përkatëse të AU. Analiza për këtë program është përfshirë brenda këtij raporti institucional. <i>Evidenca : 6.13 Raport Vjetor Insitucional v.a 2022-2023.</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime	AU përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit nëpërmjet vrojtimit të orëve mësimore. Institucioni përdor edhe metoda indirekte të vlerësimit, kryesisht përmes realizimit online të anketave anonime të studentëve për të vlerësuar procesin e mësimdhënies dhe pedagogët, fokus-grupe, dhe raporte vetëvlerësimi të pedagogëve. <i>Evidenca: 3.3 Shembull pyetësori i plotësuar në Microsoft Forms - Bachelor në "Financë-Bankë"</i> <i>Evidenca: 6.7.Shkrese fokus-grupe 2019-2023</i>

lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	<i>Evidenca: 6.9.f Rezultatet e pyetësorit drejtuar studentëve v.a. 2021 – 2022</i> <i>Evidenca: 6.9.g Rezultatet e pyetësorit drejtuar personelit akademik v.a. 2021 – 2022</i>		
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	Metodat e tërthorta të vlerësimit të programit të përdorura përfshijnë pyetësorët realizuar me studentët, monitorimin e orëve të mësimi dhe të gjithë procesit të mësimdhënies, analizën e rezultateve të studentëve në provime, vëzhgimin e praktikave, mbikëqyrjen e punimeve të diplomave, etj. AU ka një listë marrëveshjesh me aktorë të tregut të punës dhe realizon pyetësorë me Alumni. Zyra e Karrierës dhe Alumnit (ZKA) nëpërmjet raporteve të statistikave të punësimit të studentëve, kryen edhe në vlerësimin e dijeve dhe kompetencave të përfutuara nga ky program. <i>Evidenca: 1.10 Marrëveshje bashkëpunimi.</i> <i>Evidenca: 2.6 Model pyetësor Alumni.</i> <i>Evidenca: 5.14 Statistika të punësimit të studentëve</i>		
Konkluzione	<i>Institucioni përdor metoda të ndryshme për vlerësimin e programeve, si anketa të studentëve, fokus-grupe dhe monitorim të mësimdhënies. Megjithatë, mungojnë analiza për dobësitë dhe praktikën e mira për motivimin e stafit. Përmirësimi i këtij aspekti do të rriste cilësinë e programit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të	Në dokumentet e institucionit është parashikuar prezenca dhe kontributi i aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Në rregulloren e NJSBC përcaktohet si në nivel institucional, ashtu edhe në GVB në nivel njësie kryesore, është parashikuar që krahas personelit akademik duhet të ketë edhe

brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	përfaqësim nga studentët. <i>Prezenca e aktorëve të jashtëm ka qënë ose e papërfillshme ose e munguar në rastin e programit të studimit Bachelor në Financë- Bankë.</i> <i>Evidenca : 6.11 Rregullore NJSBC</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në rregulloren e NJSBC dhe aktet e tjera janë të përcaktuara qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për NJSBC (neni 4), GVB (neni 6), njësinë kryesore, njësinë bazë dhe vetë stafin akademik në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë. <i>Në realitet, nuk ka pasur raste të analizës dhe përcaktimit të ndonjë përgjegjësie të drejtpërdrejtë apo të deleguar për programin e studimit gjatë periudhës që nga fillimi i këtij programi.</i> <i>Evidenca : 6.11 Rregullore NJSBC</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Në rregulloren e NJSBC dhe aktet e tjera janë saktësuar përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për NJSBC (neni 4), GVB (neni 6), njësinë kryesore, njësinë bazë dhe vetë stafin akademik në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë. <i>Evidenca : 6.11 Rregullore NJSBC</i> <i>Evidenca: 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise 2022 - 2025.</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në të gjithë veprimtarinë lidhur me vlerësimin dhe analizën e ecuresë së programit të studimit, respektohet liria dhe integriteti akademik i pedagogëve, shmangen shkeljet e të drejtave të individit, dhe respektohet barazia midis stafit dhe studentëve. Nuk është lejuar dhe nuk lejohet asnjë shfaqje diskriminimi apo mosrespektimi. <i>Evidenca : 6.11 Rregullore NJSBC</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Strukturat e ngritura për sigurimin e cilësisë në institucion përbëhen nga stafi akademik dhe një përfaqësues i studentëve. GVJ nuk evidentoi bashkëpunim të drejtpërdrejtë me bashkëpunëtorë të jashtëm për marrjen e ekspertizës prej tyre. Në takimet me përfaqësues të biznesit apo me specialistë të fushës së programit, të cilët kanë zhvilluar leksione të hapura, mund të jenë marrë mendime të tërthorta për rritjen e cilësisë së mësimdhënies. <i>Evidenca : 6.11 Rregullore NJSBC</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i>

Konkluzione	<i>Institucioni ka parashikuar në dokumentet e tij kryesisht përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe pjesërisht në mënyrë të tërthortë bashkëpunëtorëve të jashtëm në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Veprimtaria e AU në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, si dhe politikat apo strategjitë përkatëse, janë të hapura, janë publikuar në aktet kryesore të universitetit dhe janë të disponueshme në faqen zyrtare të universitetit. <i>Evidenca : 6.11 Rregullore NJSBC</i> <i>https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Në rregulloren e NJSBC janë parashikuar parimet kryesore mbi të cilat ndërtohet siguri i brendshëm i cilësisë. Raportet dhe vlerësimet e realizuara nga NJSBC janë objekt diskutimi në njësinë bazë, dhe për raste specifike shqyrtohen edhe me njësitë drejtuese. Nuk ka raporte apo analiza që lidhen drejtpërdrejt me programin e studimit. <i>Evidenca : 6.11 Rregullore NJSBC</i> <i>Evidenca: 6.4 Strategjia për Sigurimin e Cilësisë 2022 - 2025.</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Departamenti i Shkencave Ekonomike (DSHE), si njësi bazë që mbulon dhe drejton programin e studimit Bachelor në Financë-Bankë, angazhohet me vendime të veçanta sipas rastit, duke u mbështetur në njësinë kryesore ose në rektorat, për të ndërtuar planin e masave që synojnë plotësimin e mangësive dhe përmirësimin e situatave kur ka pasur nevojë. Kjo realizohet përmes zhvillimit të trajnimeve për stafin në aspekte pedagogjike dhe didaktike. <i>Evidenca : 6.8.a Raport Semestral departamenti.</i> <i>Evidenca 6.8.b Raport vjetor Departamenti</i> <i>Evidenca 3.1.c Axhenda e trajnimeve e stafit akademik 2022-2023</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në	Nga shqyrtimi i programit të studimit dhe syllabusve, rezulton se gjatë 3-4 viteve të fundit nuk është bërë ndryshim në programin mësimor brenda kufirit prej 20%, por vetëm janë bërë azhurnime në programet e lëndëve.

përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<i>Evidenca: 2.1 Kurrikula e programit të studimit Bachelor në "Financë-Bankë".</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	AU, njësia kryesore dhe strukturat e tjera kanë organizuar herë pas here veprimtari periodike me studentët, si dhe me personelin, për të informuar dhe ndërgjegjësuar të gjithë pjesëmarrësit lidhur me nevojën dhe domosdoshmërinë e përmirësimit të cilësisë. <i>Vizita e GVJ në institucion</i>			
Konkluzione	<i>Në përgjithësi, veprimtaritë, analizat dhe proceset e ndërmarra për përmirësimin e brendshëm të cilësisë kanë qenë publike, transparente dhe efektive. Parimet mbi të cilat ndërtohet kjo veprimtari janë të sanksionuara në aktet e universitetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në


“Financë-Bankë”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi, syllabuset janë në përputhje me standardet kombëtare dhe të ndërtuara mbi bazën e një strategjie afatgjatë institucionale.
2. Partneritete proaktive me biznese, institucione që mundësojnë praktikën e studentëve, punësimin potencial dhe aplikimin në thirrje për projekte kombëtare e ndërkombëtare.
3. Staf administrativ i përkushtuar që ofron zgjidhje për problemet si për personelin akademik dhe për studentët.
4. Rregulla të përcaktuara për funksionimin e procesit mësimor, zbatimi i të cilave monitorohet rigorozisht dhe vendosja e një komunikimi të hapur midis departamentit dhe pedagogëve apo studentëve si edhe midis pedagogëve dhe studentëve.
5. Vendndodhje strategjike dhe infrastrukturë e përshtatshme.
6. Strukturë organizative efektive.
7. Departamenti i Shkencave Ekonomike zotëron infrastrukturën e nevojshme dhe të përshtatshme për zhvillimin korrekt dhe në përputhje me objektivat e kurrikulave të tij, të leksioneve/seminareve dhe praktikave.
8. Institucioni vë në dispozicion të mësimdhënies teknologji moderne (projektorë, PC, etj.) dhe është i hapur ndaj propozimeve të stafit në përputhje me azhornimet e reja teknologjike në këtë drejtim.
9. Reputacioni akademik i personelit dhe dedikimit të tyre për procesin mësimor e përgjegjshmërinë ndaj studentëve garanton mbarëvajtjen e plotë të programit për të gjithë studentët.
10. Studentët e këtij programi studimi janë të motivuar dhe ndiqnin me shumë interes këtë program duke pasur marrëdhënie të mira komunikimi me stafin akademik dhe ndihmës si dhe bashkëpunim të frytshëm gjatë gjithë periudhës së studimit.
11. Universiteti ka një numër të konsiderueshëm marrëveshje bashkëpunimi me institucionet financiare dhe aktore të biznesit në vend e cila është një mundësi e madhe për punësim për të diplomuarit në këtë program studimi.

Pika të dobta:

1. Pjesëmarrje dhe aktivizim relativisht i ulët i stafit akademik dhe i studentëve në projekte dhe kërkim shkencor ndërkombëtar. (Standardi I.2, Kriteri 2)
2. Mungesa e projekteve kërkimore-shkencore të mirëfillta, kombëtare dhe ndërkombëtare, të fituara apo të zbatuara. (Standardi I.2, Kriteri 3)
3. Ngarkesa mësimore jo e balancuar mirë midis pedagogëve të kategorisë “Profesor” dhe “Doktor”, si dhe asistentëve të kategorisë “Master”/Asistentë Lektorë. (Standardi IV.1, Kriteri 1)
4. Literatura jo e përditësuar me tituj bashkëkohorë për disa lëndë mësimore/module. (Standardi II.3, Kriteri 5)



5. Numri i stafit akademik të angazhuar në këtë program ka qenë i paqëndrueshëm. Institucioni duhet të marrë masa konkrete për motivimin e stafit akademik, për të siguruar stabilitetin dhe vazhdimësinë në përbërjen e tij (Standarti IV, Kriteri 1)
6. Në kushtet e një tendence për uljen e numrit të studentëve, institucioni duhet të përgatisë dokumentacion financiar edhe në nivelin e njësisë bazë, për të përcaktuar më qartë qëndrueshmërinë financiare të programit (Standarti IV, Kriteri 5)


Rekomandime:

1. Rekomandimi nr 1 nga akreditimi i fundit i këtij programi studimi u vu re se:
Institucioni ka bërë përpjekje për të adresuar rekomandimin e lënë nga akreditimi i fundit, por ende mbetet e nevojshme mbështetja dhe inkurajimi i stafit akademik në lidhje me kërkimin shkencor, për të botuar më shumë artikuj shkencorë, si dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore(*Evidenca RVB, Tabela 19*).
2. Në funksion të kërkimit shkencor, mendojmë se duhet të pjesëmarrje e studentëve të angazhuar në këtë fushë, pasi u vu re se nuk ka studentë të përfshirë nga ky program studimi. Gjithashtu rekomandohet edhe pjesëmarrje më të gjerë e studentëve në veprimtari shkencore të organizuara nga vetë institucioni por edhe jashtë tij.
3. GVJ, bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni rekomandon balancimin më të mirë të ngarkesës së pedagogëve efektivë për të nxitur kualifikimin e mëtijshëm dhe kërkimin shkencor.
4. Në disa nga programet e lëndëve të këtij programi studimi duhet të bëhet përditësimi i literaturës bazë pasi ende ka referime të literaturës të para 10 viteve. Rekomandojmë shtimin e fondit të librave me tekste në shqip por edhe në anglisht për lëndët karakterizuese të programit, me qëllim që leksionet e parashkruara të cilat janë përgatitur nga stafi akademik, të plotësohen me këto tekste.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Finance-Bank" provided by the Higher Education Institution "Albanian University"

Strengths and affirmations

1. The study program and the syllabuses are in accordance with national standards and built on the basis of a long-term institutional strategy.
2. Proactive partnerships with businesses, institutions that enable student internships, potential employment and application to calls for national and international projects.
3. Dedicated administrative staff that provides solutions to problems for both academic staff and students.



4. Defined rules for the operation of the learning process, the implementation of which is rigorously monitored and the establishment of an open communication between the department and lecturers or students as well as between lecturers and students.
5. Strategic location and adequate infrastructure.
6. Effective organizational structure.
7. The Department of Economic Sciences engages the necessary and appropriate infrastructure for the correct development of learning and teaching processes and in accordance with the objectives of its curricula, lectures/seminars and practices.
8. The institution makes available for teaching modern technology (projectors, PC, etc.) and is open to staff proposals in accordance with new technological updates in this regard.
9. The academic reputation of the staff and their dedication to the learning process and accountability to students guarantees the full success of the program for all students.
10. The students of this study program are motivated and followed this program with great interest, having good communication relations with the academic and support staff as well as fruitful cooperation throughout the study period.
11. The University has a significant number of cooperation agreements with financial institutions and business actors in the country which is a great opportunity for employment for graduates of this study program.

Weaknesses

1. Relatively low participation and activation of academic staff and students in international scientific projects and research.
2. The lack of authentic, national and international research-scientific projects, acquired or implemented.
3. Teaching load not well balanced between "Professor" and "Doctor" category pedagogues, as well as "Master" category assistants/Assistant Lecturers. (Standard IV.1/Criterion 1).
4. Literature not up-to-date with contemporary titles for some subjects/modules (Standard II.3/Criterion 5).
5. The number of academic staff engaged in this program has been unstable. The institution should implement concrete measures to motivate the academic staff and ensure stability and continuity in its composition (Standard IV, Criterion 1).
6. Given the trend towards a decrease in student numbers, the institution should prepare financial documentation at the level of the basic unit to more clearly assess the financial sustainability of the program (Standard IV, Criterion 5).

Recommendations

1. Recommendation No. 1: From the last accreditation of this study program noted that:
The institution has made efforts to address the recommendation left by the last accreditation, but it is still necessary to support and encourage the academic staff in relation to scientific research, to publish more scientific articles, as well as participation in scientific conferences (Evidence RVB, Table 19).
2. In terms of scientific research, we think that the participation of students engaged in this field is necessary, since it was noticed that there are no students involved in this study program. Wider participation of students in scientific activities organized by the institution itself and outside it is also recommended.
3. GVJ, based on the documentation provided by the institution, recommends better balancing of the workload of effective lecturers to promote further qualification and scientific research.
4. In some of the subject programs of this study program, the basic literature should be updated as there are still references to literature from 10 years ago. We recommend increasing the fund of books with texts in Albanian as well as in English for the characteristic subjects of the program, in order to supplement the prescribed lectures prepared by the academic staff with these texts.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X